

Stanli Hinpul (dijetar anglez) thotë:
“Profeti Islam është personaliteti më i lartë në botë. Në bazë të librit të tij, ka ardhur kultura dhe përparimi për të cilat edhe perëndimorët janë borxhlinj ndaj asaj kulture.”

Shirl, ish-profesor në fakultetin e drejtësisë në Vjenë thotë: *“Njerëzia ka nderin më të madh që Muhammedi është në mesin e tyre dhe se ai i përket kësaj njerëzie. Megjithëse ishte i paditur, ai mundi që para dhjetë shekujsh të sjellë ato ligje, ku edhe ne evropianët do të jemi më të lumtur, sesa jemi sot, nëse vërtetë arrijmë t'i kuptojmë këto ligje qoftë edhe pas dy mijë vjetësh.”*

Vështrim mbi sjelljen e Profetit Muhammed

Tiranë, 2008

Titulli i librit:

Vështrim mbi sjelljen e Profetit Muhammed

[Të kontrollojmë veten]

Autori: **Ali Vafi**

Përktheu: **Redis Sheko**

Radhiti: **Vjollca Feza**

Redaktoi: **Liseda Ramaj**

Korrekttoi: **Vullnet Merja**

Përkujdesja grafike: **Liseda Ramaj**

Kapaku: **Macdesign**

Botoi: **Fondacioni i Kur'anit**

Rruga e vështirë e Profetëve, “Misioni i Profetit”

Heshtja kishte pushtuar mbarë vendin. Koha ishte në pritje të ngjarjes së madhe të përjetshme. Një nga pasardhësit e pastër të mikut të Zotit, Ibrahimit (Paqja qoftë mbi të!) ishte zhytur në një qetësi të rrallë. Në mirazhin e tij hyjnor ai ishte duke soditur kryeveprat mahnitëse e madhështore të Krijuesit. I gjithë Krijimi që nga fillimi ishte në pritje të këtij momenti. E tërë bota ishte në zanafillën e një ngjarjeje të pakrahasueshme. Kur do të vinte ai moment i premtuar? Adhurimi në vendin e Shenjtë ishte vetëm një hije dhe ky vend ishte kthyer në një vend mbytës për shkak të injorancës, të padijes e të indiferencës së njerëzve. Ai vetë e kishte parë se si arabët i mbytnin vajzat e tyre foshnje, duke i varrosur të gjalla vetëm për shkak opinionit të keq që kishin, e nuk u vinin veshin të qarave të fëmijës. Ai ishte dëshmitar i lotëve dhe i qarjeve të njerëzve, ku mungesa e ndërgjegjes

njerëzore kamzhikonte mbi jetët e tyre. Sa e sa jetimë e gdhinin natën të gërryer nga uria dhe nuk dinin se ku t'i varnin shpresat e tyre. Ai kishte parë skllavërimin e njeriut në kushtet më poshtëruese. Nuk ekzistonte as dhembshuria e as solidariteti. Rrënjët e dinjitetit njerëzor ishin tharë që të gjitha. Në këto kushte mjerimi e errësire, bota digjej për një shkëndijë drejtësie. Akoma dëgjoheshin vajtimet e nënave që kishin humbur foshnjat apo bijtë e tyre në luftra e konflikte pa kuptim. Vajtimi i tyre shurdhonte veshin e qiellit. Por, bota e zhytyr në shtypje, mjerim e injorancë kërkonte shpëtimtarin e saj; i cili, do të qetësonte zemrat njerëzore, do t'u kthente atyre lirinë dhe do t'i udhëzonte drejt së vërtetës. Toka dhe koha ishin në pragun e mbërritjes së atij çasti, të cilin e patën njoftuar të gjithë profetët; një çast i përjetshëm dhe historik, i cili, historinë e errët dhe fatkeqësinë njerëzore do t'i kthente në lumturi e në dinjitet të përhershëm dhe nga ai fis injorant e i pakulturuar do të nxirrte një perlë në historinë e botës.

Nga kulmi i errësirës, një dritë shkëlqeu në

mesin e qiellit duke hedhur rreze shprese e ngrohtësie në zemrat e njerëzve. Një zë nga qielli e thirri atë dhe i tha; **“Lexo; Me emrin e Zotit tënd që të krijoi!”** dhe kështu Shpallja hyjnore e misioni profetik zbriti mbi trupin e nderuar të Muhammed Abdullahut (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!).

Xhebraili (paqja qoftë mbi të!) u shfaq përpara të Dërguarit të Zotit dhe i dha atij lajmin e shpalljes së Profetësisë; një përgjegjësi shumë e madhe, nga fillimi e deri në Kijamet. Në këtë mënyrë, Profeti i nderuar (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), në emër të Zotit dhe duke u mbështetur tek Ai, e pranoi detyrën e vështirë të profetit; detyrën e udhëheqjes së njerëzve të humbur dhe atyre të hutuar; një rrugë shumë e gjatë dhe një detyrë shumë e vështirë. Ai, tashmë, do të përballej me njerëz që deri në atë kohë në vend të Zotit të Gjithëpushtetshëm kishin adhuruar vetëm idhuj e sende të pashpirt.

Në këtë shtypje errësire, Zotii Madhërueshëm, nga mesi i besimtarëve dhe nga brezi i tyre ngriti një njeri që për ta të lexonte Librin e Tij dhe t’i edukonte ata sipas ajeteve dhe shembujve të dokumentuar.

Në ato kohë të errëta ku mungonte drejtësia, Profeti u ngrit me arsye e argumente të qarta, dhe me mrekullinë e përjetshme, Kur'anin, që mendjen e përhumbur njerëzore ta udhëzonte drejt lumtuturisë së kësaj bote dhe të Botës Tjetër. Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ishte kaq i dhënë pas misionit të tij, saqë e harroi fare veten dhe i mbushur e i frymëzuar me dashurinë dhe mëshirën hyjnore, i duronte të gjithë mundimet e vështirësitë që sillte kjo rrugë, e megjithatë, nuk shprehu asnjëherë mërzitje. Ailexonte ajetete Kur'anit dhe duke përmendur fjalët e All'llahut të Madhërishëm lulëzohej shpirti i jetës dhe gjallërohej shoqëria. Aq shumë ishte i dhënë pas Kur'anit, saqë çdo natë deri në agim ai qëndronte duke lexuar e duke përmendur fjalët e së Vërtetës dhe zhytej në kënaqësinë e lutjeve drejtuar Zotit të Madhëruar. I Dërguari i Zotit ishte tretur në adhurimin e Krijuesit të Gjithësisë dhe i kishte hequr të gjitha vëllot e në mes tij dhe Zotit nuk kishte më pengesa. Edhe pse, atij i bëheshin shumë padrejtësi dhe mundime nga ana e njerëzve me arsye të verbër e me zemra

të sëmura, ai me anë të durimit, si një pasqyrë reflektoi mbi ta të gjitha atributet dhe virtytet e ndritshme hyjnore të Krijuesit të botës. Profeti i duroi të gjitha mundimet për hir të edukimit dhe të udhëzimit të brezave drejt së mirës dhe rrugës së vërtetë.

Profeti i mëshirës, i cili gëzonte dhe meritën e të qenit profeti i fundit i të gjithë profetëve, aq shumë ishte i përkushtuar drejt lumturisë dhe shpëtimit të racës njerëzore, sa që vetë Zoti i Lavdishëm i drejtohet atij për këtë gjë:
“ Ta Ha! Ne nuk ta shpallëm Kur'anin për të të munduar ty (Muhammed)! ”

Pika interesante këtu është që, megjithëse Profeti ngacmohej, goditej e vuante prej arabëve injorantë, idhujtarë e mohues, ai kurrë nuk hoqi dorë nga shpallja e fjalës së vërtetë dhe nga drejtimi i besimtarëve. Ky përkushtim i tij u njoh si mirësia e Profetit. Qëndrimi i tij u bë shembulli i durimit dhe i qëndresës në rrugën e së vërtetës dhe prosperitetit të qëllimeve humaniste të Islamit. Profeti i nderuar (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) duhet ndjekur si shembull në çdo veprim të tij. Ai që nga

fillimi e deri në fund është i mbuluar me mirësi dhe sjellja e papërsëritshme e tij ishte elementi kryesor i përhapjes së Islamit në të gjithë botën. Profeti është vetë mëshirë si dhe imazh i mëshirës hyjnore, e cila është qëllimi i Shpalljes së Zotit: “O Pejgamber! Ne nuk të dërguam ty, veçse mëshirë për tërë botën.” Kjo mëshirë është aq e madhe e aq e begatë, saqë krijimi kalon nëpër rrugën e drejtë nën hijen e mëshirës së Profetit. Pa dyshim, që shpjegimi më i mirë që e tregon Profetin si shembull sublim të fisnikërisë dhe të mirësisë është ai që bën shoku dhe miku i afërt e i përherëshëm i Profetit (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), Aliu në Nahxhul Balagha, ku thotë: “ Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) pasurinë e kësaj bote e llogariste si shumë të vogël dhe po kështu, e paraqiste atë përpara të tjerëve. Atë ai e shikonte si një pengesë dhe po kështu, e prezantonte atë si pengesë e pa shumë peshë pranë të tjerëve. Ai e dinte që Zoti, si respekt ndaj dëshirës së tij, botën e mbajti larg atij dhe atë ia fali të tjerëve për arsye të të qenit të pavlerë të saj.

Profeti i kishte kthyer shpinën përfitimit të kësaj bote dhe kujtimi i saj në zemrën e tij vdiste. Ai dëshironte që zbukurimet e kësaj botë të rrinin larg syve të tij, me qëllim që ai të mos qëndronte në dëshirimin e saj. Ai e këshilloi ymetin islam me paralajmërimet e nevojshme dhe me anë të lajmeve të tij të mira, ai i ftoi njerëzit drejt Xhennetit e i shpëtoi ata nga zjarri i Xhehenemit”.

Profeti, me devotshmëri e përkushtim arriti në atë pikë sa që Zoti i Lavdishëm në Kur'anin Fisnik për të provuar humbjen e zemërverbërve dhe për t'i falur ngrohtësi shpirtit të munduar e të plagosur të Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) betohet mbi shpirtin e Profetit dhe na kujton që vlera e shpirtit të tij është shumë e madhe.

Aliu (Paqja qoftë mbi të!), i cili ka qënë pranë Profetit në çdo situatë, në çdo ngjarje, emocion apo mendim të Profetit, për të, thotë: “Zoti i Lartë e ka zgjedhur Profetin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) nga pema e begatë e Profetëve, nga burimi i dritës së udhëheqjes, nga pozita e lartë dhe

e pashoqe, nga toka e Bet'hasë (vendi ku jetonin kurejshët), nga pishtarët e vendosur në mes të errësirës dhe nga burimi i urtësisë. Profeti është një mjek i cili ka ardhur për të shëruar të sëmurët e përhumbur. Ai ka sjellë balsamin e tij i cili mbyll plagët e hapura në gjirin e njerëzimit. Ai ka ardhur për të shëruar zemrat e verbëra, veshët e shurdhër dhe gjuhët memece. Me ilaçin e tij ai shëron të gjithë të sëmurët e harruar dhe ata të përhumbur”.

Në një ligjeratë tjetër thotë: “...kështu, mrekullia e shpalljes së Profetësisë zbriti nga ana Zotit të Lavdishëm mbi Hazretin Muhammed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Filizin e parë dhe kryesor të ekzistencës së tij, Zoti e kishte nxjerrë nga minierat më të mira dhe e mbolli atë në tokat më të pastra e më të dashura dhe e ujiti vetë atë. Ai e solli atë, pikërisht, nga ajo pemë që kishin krijuar profetët e tjerë. Familja e tij është familja më e mirë; paraardhësit e tij janë ata më të mirët dhe pema e ekzistencës së tij është ajo më e mira. Ajo u mboll nën përkujdesin e sigurinë e Zotit dhe u rrit nën

gjirin e familjes së nderuar. Degët e kësaj peme arritën deri në majat e qiellit dhe dora e askujt nuk mund t'i arrinte frutat e saj. Pra, Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), është shembull i të devotshmëve dhe udhërrëfyes i atyre që kërkojnë drejtim. Ai është një pishtar me dritë të shkëlqyeshme dhe një yll i ndritshëm; ai është dritë që të ndriçon me rrezet e tij rrugën e drejtë dhe të ndez jetën; ai me fjalët e tij të bën të dallosh të vërtetën nga e pavërteta dhe urdhri i tij është plotësisht i drejtë. Zoti i Madhëruar e shpalli atë Profet në një periudhë, e cila kishte shumë distancë kohore me kohën e Profetëve të tjerë e ku njerëzit ishin shkëputur nga veprat e mira dhe kombet kishin rënë në injorancë dhe në padije”.

Por, sa e madhe është mirësia e fisnikëria e Profetit, e sidomos, kur e dëgjojmë atë nga ana e njeriut i cili ka qënë krijesa më i afërt me vetë Profetin, qoftë nga ana fizike, ashtu dhe nga ana e virtyteve dhe e devotshmërisë.

Aliu (paqja qoftë mbi të!) është pasqyra e të gjitha virtyteve dhe moraleve të pastra e të shenjta të Hazretit Muhammed (Paqja dhe

bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Në fjalët e Aliut (paqja qoftë mbi të!) mund të vështrohen e të njihen aspektet e mendimit dhe botëkuptimi ndriçues i Profetit, sepse edhe vetë Aliu është i edukuar me këtë shkollë hyjnore dhe është vazhdues i së drejtës së Profetit. Me të vërtetë, asnjë njeri si Aliu nuk e ka njohur Profetin dhe as nuk e ka kuptuar pozitën e tij të caktuar nga Zoti. Edhe ne, duke u ndihmuar nga fjalët e vyera të Aliut, përpiqemi ta njohim ashtu siç duhet Profetin, sado që përpjekja jonë në njohjen e tij është veçse një pikë në oqeanin e pakufi dhe të thellë të personalitetit të Profetit të nderuar (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Pra, edhe njëherë tjetër ulemi pranë kuvendimit të Aliut (paqja qoftë mbi të!) që t'i falim freski dhe entuziazëm shpirtit tonë duke përkujtuar sjelljen dhe emrin e Profetit të nderuar (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!); ta vendosim veten në mes të këtij flladi të freskët të mëshirës hyjnore, që ndoshta edhe ne të jemi nga ndjekësit e vërtetë të rrugës së Profetit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!).

“Zoti, Profetin e Tij e dha si dritë për të na e bërë rrugën të qartë përmes Librit Udhërrëfyes. Familja e tij ishte familja më e mirë dhe më e nderuar dhe pema e ekzistencës së saj është nga pemët më të mira, ku degët e saj janë të drejta dhe frutat e saj janë me kokë poshtë, ku të mund të përfitojnë të gjithë. Vendi i lindjes së tij është Meka dhe migrimi i tij është drejt Medines së pastër, nga ku u ngrit emri i tij i nderuar dhe ftesa e tij iu drejtuar çdo cepi. Zoti i Madhëruar, atë e dërgoi me argumente të plota dhe të mjaftueshme (Kur'anin) dhe me udhëzime të qarta. Kështu, u njohën rregulla e ligje që nuk njiheshin dhe kequdhëzimet që kishin filluar të hyjnë në fetë e tjera u prenë dhe ai shpalli rregullat dhe caktimet e Zotit. Pra, kushdo që zgjedh një fe tjetër përveç Islamit, padyshim, që do t'i presë marrëdhëniet me Zotin e Madhëruar dhe rrëzimi i tij do të jetë shumë i rëndë; fundi i tij do të jetë hidhërim dhe vuajtje pa mbarim”. Më pas, Aliu (Paqja qoftë mbi të!) vazhdon të na shpjegojë mënyrën e jetesës së Profetit të Islamit (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), të

cilën, na e paraqet kështu: “Pra, ndiq rrugën e shembullin e Profetit të pastër, sepse Profeti është shembull pastërtie për ata që kërkojnë model. Ai është burim madhështie e fisnikërie për atë person që kërkon madhështi dhe personi më i dashur i Zotit është ai që ndjek Profetin dhe shembullin e tij dhe i hedh hapat në gjurmët e tij.

Profeti (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) nuk hëngri në këtë botë që të mbushte gojën dhe as cepin e syrit nuk ia hodhi kësaj bote. Të dy veshkat e tij ishin ato më të voglat dhe barku i tij ishte ai më i zbrazëti. Atij i ofruan botën, por nuk e pranoi. Kur e dinte që dikush ishte armik i Zotit, atë e bënte edhe armik të vetes, e nëse Zoti përbuzte diçka, edhe ai e përbuzte, e atë gjë që Zoti e shikonte si të vogël, të vogël e shikonte dhe ai...

Profeti ulej përdhe dhe hante ashtu si një skllav. Ai ulej në mënyrë shumë të thjeshtë. Me duart e tij i lidhte këpucët dhe vetë e qepte rrobën e tij. Ai hipte mbi gomar pa samar dhe pas vetes hipte dhe ndonjë tjetër.

Një perde varej mbi derën e shtëpisë së tij, pas së cilës dukej një pamje. Njëherë, i tha njëerës prej bashkëshorteve: “Ma hiq nga sytë këtë perde, se sa herë e shoh më kujtohet kjo botë dhe zbukurimet e saj. Profeti (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), e hoqi zemrën nga kjo botë dhe i shkuli rrënjët e saj nga shpirti i tij”.

Nëse vështrojmë begatitë e mëdha hyjnore që zbritën mbi Tokë në kohën kur u shpall Profeti i Islamit (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), kuptojmë mënyrën se si ai i bindi njerëzit që t’i besonin dhe me anë të ftesës së tij t’i bashkonte ata; si i shpalosi bekimet hyjnore përmbi ta, duke u hapur atyre rrugët e lehtësimit dhe të mirëqënies.

Ata u zhytën në mes të begative të pafund dhe jeta e tyre u mbush plot gjallëri. Çështjet e tyre shoqërore u shëndoshën dhe u vendosën nën hijen e fuqisë së pushtetit të Islamit; u qetësuan në bazë të madhështisë së besimit dhe arritën qëndrueshmëri në qeverisje. Në atë kohë, ata u bënë sunduesit dhe drejtuesit e botës dhe mbretër përmbi Tokë.

“O Zot! O Zgjerues i çdo zgjerimi! O Mbajtësi i qiejve! O Krijues i zemrave! Lavditë e Tua më të çmuara dhe bekimet e tua më të larta jepja Muhammedit (Paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), që është i Dërguari Yt dhe Profeti i fundit; ai është çelësi i dyerve të mbyllura dhe dalluesi i së vërtetës; ai është varrmihësi i ushtrive të së shtrebrës; ai është rrëzuesi i të pavërtetës dhe i idhujve; ai pranoi detyrën e rëndë të Profetit dhe për hir të urdhrit Tënd u ngrit më këmbë dhe menjëherë, eci drejt rrugës së kënaqësisë Tënde; madje, as edhe një hap ai nuk u step dhe as nuk u përkul në këtë mision. Ai në pranimin e Shpalljes hyjnore ishte shumë i fuqishëm, ruajtës dhe mbrojtës i lidhjes dhe i besës së dhënë. Ai u përpoq në zbatimin e urdhrit Tënd, që të shikohej drita e së vërtetës, e rruga për injorantët të ndriçohej dhe zemrat që ishin zhytyr në gjynah gjetën rrugë drejtimi.

Ai ngriti lart flamujt e së vërtetës dhe vuri në themele rregullat e ndritshme. Ai është Profeti i sigurt dhe i besueshëm, vendosës i dijes e i

njohurisë Tënde. Ai është dëshmitar i Ditës së Ringjalljes. Ai u ngrit për të shpallur të vërtetën dhe është i dërguari Yt tek njerëzit.

O Zot! Hap një vend shumë të gjërë në mirësinë Tënde për Profetin (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe shtoji shpërblimet e bekimet e Tua për të!”

Me anë të këtij libri shpresojmë që dashamirësit e dijes fetare të ndjekin rrugën e Profetit të nderuar, sepse më i dashuri te Zoti i Madhëruar është ai që hedh hapat në gjurmët e të Dërguarit të Tij.

Dr. Mohammad Reza Aram

Drejtor i Fondacionit të Kur'anit

Hadith

I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë: ***“Çdo njeri që gëlltit përbrenda zemërimitin e vet, ndërkohë që ka mundësi që ta shfryjë atë, Zoti do t’ia mbushë zemrën me siguri dhe besim.”***¹

Burri që kërkoi këshillë

Një burrë erdhi nga shkretëtira në Medine të takonte të Dërguarin e Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Ai i kërkoi Profetit këshilla dhe udhëzime. Profeti i nderuar i tha atij vetëm: *“Mos u zemëro!”* dhe nuk shtoi gjë tjetër. Burri u kthye tek fisi i vet. Rastësisht, kur mbërriti atje, mësoi se gjatë mungesës së tij kishte ndodhur një ngjarje e rëndësishme; të rinjtë e fisit të tij kishin marrë mallrat e një fisi tjetër, pastaj, edhe ata të fisit tjetër kishin vepruar në të njëjtën mënyrë; kështu, të dy fiset ishin rreshtuar përballë njëri-tjetrit të gatshëm për luftë.

Ky lajm i zgjoi atij zemërimitin. Menjëherë, kërkoi armët dhe u rreshtua përkrah fisit të vet. Papritur, iu kujtua këshilla e Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), që të frenonte zemërimitin e tij. Ra në mendime... “pse ia lejova vetes të inatosem, pse i ngjesha

¹ *Kenzul Ummal, vëll. 3, faqe 131.*

armët dhe u bëra gati për të vrarë dhe për t'u vrarë...?”

Duke pasur parasysh fanatizmin në respektimin e rregullave dhe ligjeve fisnore siç ishte hakmarrja apo përpjekja për dominim që gjendej në mesin e arabëve, cilën rrugë do t'i këshillonit ju këtij burri?

▫ Të hidhej në luftë dhe gjakderdhje së bashku me shokët, sipas ligjeve të fisit.

▫ Të kontrollonte zemërimin e vet dhe të mendonte në mënyrë të arsyeshme për të ndaluar gjakderdhjen.

▫ Të mënjanohej për vete dhe të nxiste të tjerët për luftë.

▫ Ta shtynte për më vonë veprimin sipas këshillës së Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) në mënyrë që të mos e quanin frikacak.

Përgjigjen e saktë të vazhdimit të tregimit do ta zbuloni në faqen 92.

Hadith

I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë: ***“Shpirtmadhësia jonë, pra, e Ehli Bejtit qëndron tek falja e atyre të cilët kanë lejuar padrejtësi përmbi ne dhe po ashtu, i japim atyre që nuk na japin.”***¹

Beduini dhe Profeti Muhammed

Një arab (beduin) shkoi në xhaminë e Medines me shpresën se mos vallë do të merrte argjend e flori nga Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Kur hyri në xhami, pa Profetin mes shokëve të tij dhe i shprehu atij atë që kërkonte. Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) i dha diçka, mirëpo, ai nuk u kënaq dhe e konsideroi atë pothuajse hiçgjë; për më tepër, mori guxim kundër Profetit dhe filloi të fliste fjalë të ashpra dhe të vrazhda ...

Si mendoni për vazhdimin e tregimit dhe për sjelljen e Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) me beduinin?

▫ I tha shokëve të tij që ta rrahin atë burrë të

¹ *Biharul Anuar, vëll. 74, faqe 143.*

paedukatë dhe ta flakin jashtë xhamisë.

▫ I tha shokëve të tij që të mos kenë punë me të, të mos i kushtojnë vëmendje dhe le të thotë çfarë të dojë derisa të lodhet dhe të largohet.

▫ Iu përgjigj paedukatës së atij burri me dashuri dhe butësi dhe e ndihmoi atë me një masë tjetër derisa ai u kënaq dhe u largua i gëzuar nga Medineja.

▫ Meqë e kishte për herë të parë, e fali atë burrë dhe e urdhëroi që të ikte dhe të mos kthehej më.

Mendoni rreth këtyre përgjigjeve dhe imagjinoni: “Nëse do të kishit qenë ju, si do të vepronit? Më pas, lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 93.

Hadith

I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë: ***“Zoti i Madhëruar do që të jeni të drejtë mes fëmijëve tuaj madje, edhe kur t’i puthni ata.”***¹

Mëshira dhe dashuria

Një ditë Profeti i nderuar (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ishte ulur dhe e kishte marrë njërin prej fëmijëve të vet mbi prehër dhe po e puthte me dashuri. Në këtë kohë, një burrë prej aristokratëve të periudhës së injorancës shkoi te Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe i tha: “Unë kam dhjetë djem dhe deri tani ende s’kam puthur asnjërin prej tyre as edhe për një herë të vetme...”

Si mendoni se reagoi Profeti kur dëgjoji të tilla fjalë dhe çfarë përgjigjeje i dha burrit?

¹ *Kenẓul Ummal, vëll. 16, faqe 445.*

- Të puthësh apo të mos puthësh fëmijët nuk ka rëndësi; e rëndësishme është që t'i duash ata me zemër.
- Kjo gjë është prej veçorive të aristokratëve, ndërsa ne nuk jemi të tillë.
- Ndoshta ti nuk i do djemtë e tu, ndërsa unë i dua fëmijët e mi, prandaj, edhe i puth ata.
- Ngaqë në zemrën e atij burri nuk gjendej mëshirë dhe dashuri, Profeti u shqetësua pa masë dhe shprehu keqardhje.

Lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 95.

Hadith

I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Kushdo që fal kur është i fuqishëm, Zoti do ta falë atë në ndonjë ditë të vështirë.”¹

Falja në kohën e fuqisë

Një çifut (jahudi), që pretendonte se i kishte dhënë hua Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), iu afrua atij dhe i kërkoi që në atë çast, po në atë rrugicë që ia kishte dhënë huanë po aty duhej t'ia kthente atë.

Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) tha: “Ju nuk më keni dhënë hua mua dhe më lejon që unë të shkoj në shtëpi dhe të sjell para për ty, sepse nuk më ndodhet gjësend me vete.” Çifuti iu përgjigj: “Nuk të lejoj që të hedhësh asnjë hap prej këndeje.” Sado që Profeti u tregua i butë me të, ai u zemërua edhe më shumë dhe i kapi mantelin duke ia mbështjellë atë rreth qafës dhe duke e tërhequr aq fort sa që më pas do të mbeteshin gjurmët e skuqjes në qafën e tij. Profeti përpara kësaj ngjarjeje ishte nisur drejt xhamisë për të thirrur ikametin e namazit me xhemat dhe si pasojë e kësaj të papriture, u vonua. Koha kaloi dhe Profeti s'po dukej. Dolën dhe panë se një çifut i kishte

¹ El Xhamiu Sagjir, vëll. 2, faqe 623.

prerë rrugën të Dërguarit të Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe nuk po e linte atë të qetë...

Nëse do të gjendeshit në një situatë të tillë dhe njëkohësisht do të kishit fuqinë për t'u hakmarrë, si do të vepronit?

▫ Do të kërkonit nga miqtë tuaj që ta godisnin aq fort atë njeri sa të shlyente atë veprim që kishte guxuar të bënte.

▫ Do ta ndëshkonit vetë atë, aq sa të mos guxonte më që të kryente një veprim të tillë.

▫ Do t'ia dorëzonit atë autoriteteve përgjegjëse për ta ndëshkuar për krimin e dhunimit, e përbuzjes dhe të pafytyrësisë.

▫ Do të silleshit butësisht përballë veprimit të tij të shëmtuar, aq sa të turpërohej dhe të kërkonte falje për veprimin e tij.

Vëreni edhe një herë me kujdes zgjidhjet dhe shikoni nëse me të vërtetë do të kishit vepruar sipas asaj zgjidhjeje të cilin e keni shënuar; pastaj, lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 95 që të kuptoni se si veproi Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!).

Hadith

“Ai, që barrën e vet ua hedh të tjerëve mbi shpinë, është i mallkuar”¹

Ushqimi i përbashkët

Sapo Profeti i nderuar dhe shokët e tij zbritën nga devetë dhe shkarkuan ngarkesën, së bashku vendosën që të thernin një dele dhe ta përgatisnin për ta ngrënë.

Njëri prej shokëve tha: “Kokën deles do t’ia pres unë.”

Tjetri tha: “Lëkurën do t’ia rrjep unë.”

I treti tha: “Unë do pjek mishin.” E kështu me radhë foli i katërti, etj.

Profeti i nderuar tha: “Unë do të mbledh shkarpa për zjarr në shkretëtirë.” Shokët u hodhën: “O i Dërguari i Zotit, ju nuk keni përse të mundoheni, prandaj, rrini i qetë; ne do ta kemi për nder që t’i kryejmë të gjitha këto punë...”

Nëse do të kishit qenë kujdestar në një udhëtim në grup, si do të vepronit përballë këtyre propozimeve? Do të thonit:

¹ El Kafj, vëll. 5, faqe 72.

- Meqë s'ka shumë punë, atëherë unë po rri e po çlodhem.
- Nëse ka bashkëpunim, atëherë unë si më i madhi dhe si kujdestar grupi që jam nuk duhet t'u përvishem këtyre punëve pothuajse çikërrima.
- Meqë ky është një udhëtim në grup secili duhet që sipas mundësisë së vet të marrë përsipër kryerjen e ndonjë pune dhe kështu edhe unë duhet të punoj sikurse gjithë të tjerët.
- Detyra ime është vetëm të drejtoj punët, ndërsa të tjerët duhet të kryejnë punë të ndryshme.

Nëse doni të dini se si iu përgjigj Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) propozimeve të shokëve, lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 96.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: ***“Ai, që me sjelljet e tij të këqia shkakton pasiguri te fqinjët e tij, nuk do të hyjë në Xhennet.”***¹

Fqinji i ri

Një burrë nga përkrahësit (ensarët) bleu një shtëpi të re në një nga lagjet e qytetit të Medines dhe u zhvendos atje. Aty vuri re se i kishte rënë për pjesë të bashkëjetonte me një fqinj të pakëndshëm. Shkoi te Profeti i nderuar dhe i tha: “Kam blerë një shtëpi në një lagje në mes të një fisi dhe jam zhvendosur atje. Fatkeqësisht, fqinji im më i afërt është një njeri, nga i cili, jo vetëm që nuk kam ndonjë të mirë e as nuk ndjehem i lumtur me fqinjësinë e tij, por edhe nuk jetoj i sigurt prej frikës së sherrit të tij. Nuk jam i sigurt nëse ai nuk po planifikon dëmtimin tim...”

Deri tani, a keni menduar rreth të drejtave të fqinjëve mes njëri-tjetrit dhe a keni dëgjuar ndonjë gjë rreth respektimit të të drejtave të

¹ Mustedrek el Uesail, vëll. 8, faqe 425,

fqinjtit nga këshillat e shumta të Profetit të nderuar (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), nga familja e nderuar e Profetit (paqja qoftë mbi ta!) dhe nga figurat e mëdha të fesë? E, si është sjellja juaj me fqinjët?

▫ Nëse zhurma të ndryshme, nëse hyrje dhe dalje në orët e vona të natës, nëse gjurulldia që bëjnë fëmijët bëhen shkak për shqetësimin e fqinjëve, ju nuk i jepni rëndësi dhe thoni: Brenda katër mureve të shtëpisë time bëj çfarë të dua.

▫ Do të hyni e do të dilni me fqinjët; do të jeni të njohur me gjendjen e njëri-tjetrit; e dini se ç'nevoja kanë dhe do të përpiqeni me sa të mundeni për zgjidhjen e problemeve të tyre, sepse Profeti i nderuar (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë: ***“Xhebraili më ka porositur aq shumë për fqinjët, sa që kam menduar se fqinji i lë fqinjët pasurinë e tij si trashëgim.”***²

▫ Nuk ju duhet gjë se ç'bëjnë fqinjët; ata nuk kanë ndonjë dëm nga ana juaj e gjithashtu, as ju nuk i zgjidhni ndonjë problem atyre. Besoni se në këto kohë sa më pak marrëdhënie të kesh,

2 Uesail shiah, vëll 2, hadithi 1307.

aq më e lehtë është jetesa. Çfarë njerëzish janë fqinjët dhe çfarë bëjnë ata nuk lidhet me ju. “Musai në fe të vet, Isai në fe të vet.”

▫ Nëse sjellja e fqinjëve bëhet motiv i prishjes së qetësisë dhe kohë pa kohë ju shkaktojnë parehati, në vend që ta frenoni zemërimin dhe ta zgjidhni problemin miqësisht, me logjikë dhe me mirësjellje, menjëherë, tronditeni dhe në mënyrën më të rreptë synoni ta ofendoni.

Le ta lexojmë vazhdimin e tregimit në faqen 97 që të bëhet e qartë për ne rëndësia e temës e që këtej e tutje të jemi më të kujdesshëm me sjelljen tonë.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka urdhëruar:
***“Bëhuni të thjeshtë dhe bashkohuni me të
mjerët që të jeni prej të mëdhenjve të Zotit
dhe të largoni mendjemadhësinë.”***¹

I mjeri dhe pasaniku

I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) po rrinte si zakonisht në xhaminë e vet. Shokët e kishin rrethuar dhe e kishin vënë në mes, sikurse kllapat e unazes të cilat mbajnë të mbërthyer gurin e çmuar duke mos lejuar që ai të bjerë prej saj. Një mysliman, i cili ishte një burrë i varfër dhe i veshur me rroba të rreckosura hyri brenda nga dera. Sipas traditës islame, kushdo qoftë dhe çfarëdo pozite që të ketë, sapo që hyn brenda në mbledhje a në kuvend duhet të hapë sytë se ku mund të gjejë ndonjë vend të lirë për t'u ulur dhe të mos e ketë mendjen në ndonjë vend tjetër me pretekstin se pozita ime ma kërkon një favorizim të këtillë. Burri zuri të vështrojë për ndonjë vend të lirë dhe së fundi, gjeti diku një vend, ku shkoi dhe u ul. Fati qëllloi që të ulet përkrah një burri me pozitë dhe pasanik.

1 Halijt el enlija, vëll 8, faqe 197.

Burri pasanik i mbledhi plaçkat e veta dhe u zhvendos më larg...

Nëse do të ishit të ulur në ndonjë mbledhje a në ndonjë kuvend dhe nëse aty do të futej ndonjë burrë i varfër, në ç'mënyrë do të silleshit me të?

▫ Sikur të ulej përkrah jush, do ta spostonit veten matanë sikurse rasti i burrit pasanik dhe do të vepronit në atë mënyrë që do ta turpëronit.

▫ Qëllimisht, do të uleshit në mënyrë të atillë që të mos kishte vend të mjaftueshëm për t'u ulur dy vetë dhe si pasojë ai do të ikte diku tjetër.

▫ Do t'i lironit vend atij dhe do ta pranoni me dashamirësi, në mënyrë që të mos ndihej i fyer.

▫ Nëse do të ulej përkrah jush dhe do të shqetësohej nga mospërfillja juaj, juve nuk do t'ua lejonte kryelartësia që t'i kërkonit falje.

Nëse e lexoni me kujdes vazhdimin e tregimit në faqen 97 do ta kuptoni se cila është ajo sjellje që bëhet shkak i kënaqësisë dhe i zemërimit të Zotit dhe tek i Dërguari i shtrenjtë i Tij.

Hadith

I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), ka urdhëruar:
“Mirësia ndaj gruas është mbarësia e fejesës dhe e prikës së saj.”¹

Xhujberi dhe Zelfa

- “Sa mirë do të ishte sikur të martoheshe, të krijoje familje e t’i jepje fund vetmisë sepse jo vetëm që ke nevojë për grua por, gjithashtu, gruaja të ndihmon si në punët e kësaj jete ashtu edhe të Jetës Tjetër.”

- “O i Dërguar i Zotit! Unë nuk kam as mall dhe as bukuri, jam njeri pa njeri, e kush më jep grua mua; e kush vallë është ajo grua që dëshiron të bëhet bashkëshorte e një burri të varfër, shtatshkurtër, të zi dhe të shëmtuar si unë?!”

- “O Xhujber! Zoti nëpërmjet Islamit i ka ndërruar vlerat e njerëzve. Shumë prej atyre që kanë qenë të respektuar në periudhën e injorancës, feja i ka bërë që të bien poshtë. Mjaft njerëz në kohën e injorancës ishin të poshtëruar dhe pa ndonjë vlerë, ndërsa Islami ua ngriti atyre vlerat dhe pozitën. Zoti, nëpërmjet Islamit i fshiu mendjemadhësinë, injorancën dhe krenarinë që lidhej me racën dhe me familjen. Tashmë, të gjithë njerëzit, si të

1 Musnedi Ahmed, vëll. 6, faqe 91.

bardhë ashtu edhe të zinj, kurejshë e jokurejshë, arabë dhe joarabë janë në një shkallë. Askush nuk ka përparësi ndaj tjetrit, veçse nëpërmjet devotshmërisë dhe adhurimit. Unë në mesin e myslimanëve shikoj më lart se ty vetëm atë njeri, i cili është më i devotshëm dhe më i ditur se ty. Tani bëj si të të urdhëroj unë.”

Këto ishin disa fjalë që u shkëmbyen mes Profetit të nderuar (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!) dhe Xhujberit, një ditë kur Profeti kishte ardhur për të takuar “Shokët e Sufesë”. Xhujberi ishte nga ana e Jumamesë. Ai kishte qenë atje kur kishte dëgjuar për Islamin bashkë me ardhjen e Profetit të fundit. Ai, sado që ishte i vobektë, i zi dhe shtatshkurtër, prapëseprapë, ishte i zgjuar, kërkues i së vërtetës dhe njeri me vullnet. Pasi dëgjoji **zërin e Islamit**, erdhi menjëherë në Medine që të shikonte më nga afër rrjedhën e ngjarjeve. Nuk kaloi shumë kohë dhe pranoi Islamin e u bashkua me myslimanët; mirëpo, për shkak se nuk kishte as para, as shtëpi dhe as të njohur, me urdhër të Profetit qëndroi përkohësisht në xhami. Pak nga pak, në mesin e personave të tjerë që u bënë myslimanë dhe që qëndronin në Medine u gjendën persona të tjerë, të cilët, sikurse edhe Xhujberi ishin të varfër dhe të mjerë. Me urdhër të Profetit edhe këta vendoseshin në xhami, derisa i

erdhi shpallja Profetit që xhamia nuk ishte vendbanim dhe këta duhej që të bënë shtëpi poshtë xhamisë. Profeti caktoi një vend jashtë xhamisë dhe ngriti atje një strehë të madhe kundra diellit dhe i vendosi ata tek ajo strehë. Atë vend e quanin “Sufe”, ndërsa banorët e saj, të cilët ishin si të varfër ashtu edhe të huaj quheshin “Shokët e Sufesë.” I Dërguari i Zotit dhe shokët e tij kujdeseshin për gjendjen dhe jetesën e tyre. Një ditë i Dërguari i Zotit shkoi për t’i takuar ata. Në mes të të gjithëve i zunë sytë Xhujberin dhe mendoi që ta nxirrte Xhujberin nga kjo situatë dhe t’i jepte zgjidhje jetës së tij. Mirëpo, gjëja e vetme, e cila nuk i shkonte kurrë ndërmend Xhujberit, duke patur parasysh gjendjen e tij ishte kjo, që ai një ditë do të kishte grua, shtëpi dhe gjërat elementare të jetesës. Kjo ishte arsyeja që kur i Dërguari i Zotit i propozoi atij që të martohej, ai me habi iu përgjigj: “Vallë, a mundet ndokush të pranojë e të martohet me mua?!” Mirëpo, Profeti e nxori menjëherë atë prej gabimit të tij duke e vënë në dijeni mbi përparimin e gjendjes shoqërore si rrjedhojë e ardhjes së fesë islame. Profeti,, pasi e nxori Xhujberin prej gabimit dhe e bëri të sigurt dhe optimist për jetën, i dha urdhër që të shkonte menjëherë tek shtëpia e Zijad ibn Labid Ensarit dhe të kërkonte dorën e së bijës, Zelfës për martesë. Zijad ibn Labidi ishte nga

njerëzit më të pasur dhe më të respektuar të Medines. Fisi i tij e respektonte shumë. Kur hyri Xhujberi në shtëpinë e Zijadit pa që ishin mbledhur shumë prej të afërmeve dhe prej të fisit të Lebidëve. Xhujberi, pasi u ul, heshti për pak kohë dhe pastaj ngriti kokën dhe i tha Zijadit: “Unë kam një lajm nga ana e Profetit për ju, a të flasim veçmas apo ta them hapur?”

- “Lajmi i Profetit është nder për mua, sigurisht që ta thuash haptazi.”

- “Profeti më ka dërguar që të të kërkoj dorën e vajzës tënde, Zelfës.”

- “Profeti vetë ta ka thënë ty këtë gjë?!”

- “Unë nuk flas nga vetja, të gjithë më njohin dhe e dinë se nuk jam gënjeshtar.”

- “Është e habitshme, ne nuk e kemi për zakon që t’ia japim vajzën dikujt tjetër, përveç atyre të rangut tonë. Ti shko, unë do të shkoj e ta takoj vetë Profetin dhe do të bisedoj vetë me të për këtë çështje.”

Xhujberi u ngrit nga vendi dhe doli nga shtëpia e ashtu duke ecur thoshte me vete: “Pasha Zotin, ajo çka na mëson Kur’ani dhe ajo për çka është profetësia e Muhammedit është tjetër gjë me atë që thotë Zijadi.” Kushdo që i kalonte pranë, i dëgjonte fjalët që pëshpëriste Xhujberi me vete. Zelfa, e bija e Labidit, e cila ishte e njohur për bukurinë e saj, i dëgjoi fjalët e Xhujberit dhe shkoi pranë të atit që të mësonte

se si qëndronte puna. “O baba, ky njeri që sapo doli nga shtëpia, çfarë po pëshpëriste me vete dhe çfarë qëllimi kishte?”

- “Ky burrë erdhi të kërkonte dorën tënde dhe pretendonte se e kishte dërguar Profeti.”

- “Po sikur atë ta ketë dërguar me të vërtetë Profeti, atëherë mospranimi konsiderohet mosbindje ndaj urdhrin të tij.”

- “Ti i beson? Si duhet të bëj?”

- “Unë besoj se duhet ta kthejmë shpejt atë në shtëpi përpara se ai të mbërrijë tek Profeti dhe shko vetë tek Profeti dhe zbulo të vërtetën...”

Nëse do të kishit qenë në vend të Zijad ibn Labidit, si do të kishit vepruar ndaj këtij propozimi?

▫ Do të thonit: Po e pranoj meqenëse është propozimi i të Dërguarit të Zotit dhe s’kam përse të kërkoj rreth saktësisë së kësaj çështjeje, madje, as edhe ta pyes time bijë.

▫ Do të kërkonit prej tij një mundësi për t’u menduar rreth gjithë kësaj, e më pas do të fillonit kërkimet rreth saktësisë së kësaj çështjeje, e pasi që të ishit këshilluar dhe të kishit diskutuar me vajzën tuaj, do jipnit përgjigjen për martesë sipas mendimit të saj.

▫ Me të dëgjuar këto fjalë do të zemëroheshit

duke thënë se jeni një familje e nderuar dhe e pasur dhe nuk ia jepni kurrë bijën një njeriu të vobektë.

▫ Do të thonit: Urdhri i të Dërguarit të Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) është i saktë, mirëpo, kërkoj edhe disa kushte. Të duhet të paguash kaq apo aq mehr, të keni shtëpi të këtillë apo të atillë, dhe po ashtu, të siguronit shpenzimet e jetës duke iu përshtatur pozitës tonë.

Nëse do të ishit në vendin e Zelfës dhe po të vinte e t'ju kërkonte dorën një njeri i vobektë, çfarë përgjigjeje do t'i jepnit? Do të thonit:

▫ Baba, mos e refuzo propozimin e të Dërguarit të Zotit. Unë duhet të jem e kënaqur dhe të pranoj të jetoj me të sepse meqë ky është propozim i të Dërguarit të Zotit, patjetër që është në të mirën time. Atëherë, unë duke iu bindur urdhrit të të Dërguarit të Zotit, pajtohem me këtë martesë.

▫ Ndonëse është një i ri besimtar, nuk ka asnjë pasuri dhe as bukuri, e pra, si mund të jetoj me të?!

▫ Pozita jonë qëndron mjaft lart nga pozita e tij. Miket dhe shoqet e mia që të gjitha kanë burra të pasur dhe të pashëm, prandaj unë kam turp t'u dal përpara atyre duke qenë e martuar me një të ri varfanjak si Xhujberi.

▫ Meqë atë e ka dërguar Profeti, nuk është mirë që t'ia thoni haptazi përgjigjen negative, prandaj, është më mirë që ta mbani varur atë për disa ditë e më pas, me anë të këtij preteksti se gjoja “vajza ime hëpërhë nuk ka mendje për martesë” t'i kërkon ndjesë atij.

Dhe, nëse do të ishit në vend të Xhujberit dhe do t'u bëhej një propozim i këtillë, si do të vepronit? Do të thonit:

▫ Ajo kokë që s'ka dhimbje nuk do të lidhet! Nuk martohem kurrë, derisa të bëhet e qartë gjendja e punës time dhe derisa të kem të ardhura të mirëpërcaktuara.

▫ Jam i detyruar që t'i bindem urdhrit të Profetit dhe të shkoj e të kërkoj dorën për martesë; mirëpo, e di që përgjigja e tyre është negative dhe se dinjiteti im do të poshtërohet, por sidoqoftë, do të marr hak kundra tyre në çdo lloj rruge që të jetë.

▫ Martesa është traditë e të Dërguarit të Zotit, ku njëkohësisht kam nevojë për të. Atëherë do të shkoj e t'i kërkoj dorën. Nëse pajtohem, do ta falënderoj Zotin e Madh për këtë mirësi, ndërsa, nëse përgjigja e tyre është negative, atëherë unë bëra detyrën time dhe shpresoj në dashurinë e Zotit.

▫ Nuk di se si të bëj. Nëse nuk e pranojnë

kërkesën time, atëherë është përbuzje ndaj meje dhe si pasojë do të bie në pozita ku të tjerët do të tallen me mua. Nëse do të pranojnë duhet të jem përherë kokëulur ndaj atyre dhe të kem ndjesinë e poshtërimit, sepse do të mendojnë se e bëra këtë punë për shkak të lakmisë së famës dhe pasurisë të së atit.

Pasi të keni zgjedhur njërin nga variantet e mësipërme, lexojeni vazhdimin e këtij tregimi mjaft interesant në faqen 99. Shikoni nëse varianti i zgjedhur ka qenë i saktë.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka urdhëruar: “*Hani e pini, jepni lëmoshë dhe vishni rroba pa shpërdorim dhe pa mburrje.*”¹

Paraja e bekuar

Ali ibn Ebu Talibi, u ngarkua nga Profeti i nderuar të shkonte në pazar dhe t’i blinte atij një këmishë. Pasi bleu një këmishë që kushtonte 12 derhem, ia solli Profetit. Profeti i nderuar e pyeti: - “Sa e ke blerë këtë këmishë?”

- “12 derhem” – iu përgjigj Aliu.

- “Kjo nuk më pëlqen edhe aq shumë. Dua një këmishë më të lirë se kjo. A është i gatshëm shitësi të ta kthejë sërish?”

- “Nuk e di o i Dërguar i Zotit.”

- “Shko e shiko nëse është i gatshëm të ta kthejë!”

Aliu e mori këmishën dhe u kthye te vendi ku e bleu dhe i tha shitësit: “I Dërguari i Zotit kërkon një këmishë më të lirë se kjo. A mund të marrësh këmishën e të m’i kthesh paratë?” Shitësi pranoi dhe Aliu mori paratë dhe ia ktheu Profetit. Më pas, i Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) së bashku me Aliun shkuan në Pazar.

1 Sahibu Buhari, vëll. 7, faqe 33.

A ju ka ndodhur në ndonjë rast kështu? Nëse do të donit të blinit mallra apo plaçka që gjenden në pazar të llojeve dhe çmimeve të ndryshme, si do të bënit?

▫ Do të zgjidhnit atë që është më e bukur dhe më e shtrenjtë dhe do të thonit: Paratë nuk janë të rëndësishme, duhet të blejmë llojet më luksoze të gjërave e kështu t'i gëzojmë.

▫ Kënaqësia juaj gjendet tek kjo që në vend që të zgjidhni më të mirën dhe më elegante, pajiseni me llojin më të lirë dhe diferencën që mbetet e caktoni për plotësimin e nevojave të domosdoshme të të tjerëve.

▫ Keni shumë dëshirë që të bleni llojet më elegante dhe të bukura, mirëpo, në raste pamundësie jeni të detyruar të zgjidhni llojet më të lira.

▫ Pa i kushtuar vëmendje anës së jashtme të mallrave, zgjidhni llojet më të lira dhe keni besim se në këtë mënyrë, njëkohësisht, eliminoni si nevojat e sotme, po ashtu duke qenë të kënaqur dhe duke kursyer, do të mbetet një pjesë edhe për nesër.

Nëse do të lexoni vazhdimin e tregimt në faqen 102, do ta kuptoni se si ka vepruar Profeti i nderuar (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe mënyrën se si duhet ta pasojmë ne atë.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: ***“Gjëja më e tmerrshme, të cilën druaj për ymetin tim, janë tekat dhe dëshirat e tepruara.”***

Rrobat gjithë shkëlqim

Ishte viti i nëntë i Hixhrit. Disa njerëz të krishterë prej Mexhramit që ishin të shquar në mesin e tyre erdhën në Medine që të takonin Profetin (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe të diskutonin me të rreth fesë islame. Ata kishin veshur rroba të gjata, të bukura prej mëndafshi, gjithë shkëlqim dhe nëpër gishta kishin vënë unaza të shtrenjta. Përshëndetën Profetin (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), por ai nuk ia ktheu përshëndetjen, madje, ktheu fytyrën në anën tjetër dhe nuk pranoi të bisedonte me ta.

Si silleni me ata që vijnë për t'u këshilluar dhe si reagoni juve ndaj jetës luksoze?

▫ Fillimisht, përkujdeseni për punën e atij individit i cili është veshur më shik dhe që duket më i pasur, duke mos i kushtuar vëmendje nevojave të atyre që vijnë e u drejtohen për hall.

▫ Jeni nga ata persona që i japin më shumë rëndësi zbukurimit të vendit të punës dhe banesës dhe gjithnjë rendin pas sendeve luksoze.

▫Jeni kundërshtarë të luksit dhe të pispillosjes dhe përpiqeni që me anë të sjelljes tuaj të ndaloni edhe të tjerët së jetuari në këtë mënyrë.

▫ Ju nuk keni një jetë luksoze, mirëpo, duke parë njerëzit dhe vendet luksoze mendoni: Ah, sikur edhe unë...

Lexoni vazhdimin e tregimi në faqen 104 dhe përfitoni prej fjalëve të Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!).

Hadith

I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë: ***“Për çdolloj lehtësimi për punën e shërbyesit tënd, do ta gjesh shpërblimin në peshoren e veprave të tua në Ditën e Kijametit.”***¹

Iftari

Enes ibn Maliku kishte vite që shërbente në shtëpinë e të Dërguarit të Zotit dhe këtë nder e pati deri në ditën e fundit të jetës së Profetit. Ai i njihte më mirë se kushdo tjetër moralin dhe zakonet e Profetit të nderuar. Ai e dinte sesa i thjeshtë ishte Profeti në të ngrënë dhe në të veshur. Në ditët që agjëronte i gjithë iftari dhe syfyri i tij nuk ishte gjë tjetër, veçse një masë qumështi ose sherbeti dhe një masë përsheshi i thjeshtë me lëng mishi, ndërsa ndonjëherë, mjaftohej me një vakt ushqimi dhe e vazhdonte agjërimin po me të. Një natë, si zakonisht, Enes ibn Maliku kishte përgatitur pak qumësht dhe diçka tjetër për iftarin e Profetit të nderuar, mirëpo, atë natë Profeti nuk erdhi në kohën e iftarit. Kishte kaluar një pjesë e natës dhe Profeti (paqja dhe bekimet e

1 *Sha'bul Iman; vëll. 6, f. 378.*

All'llahut qofshin mbi të!) ende nuk po kthehej. Enesi mendoi se Profeti do t'i jetë përgjigjur ftesës së ndonjërit prej shokëve dhe duhet të ketë ngrënë darkë tek ata, prandaj e hëngri vetë atë çka kishte përgatitur. Nuk kaloi shumë kohë dhe i Dërguari i Zotit u kthye në shtëpi. Enesi pyeti njërin prej shoqëruesve të Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) se ku e kishte ngrënë Profeti iftarin. Ai iu përgjigj se ende nuk kishte ngrënë iftar për shkak se ashtu i kishin dalë disa punë prandaj edhe u vonua. Enesi u pendua dhe u turpërua shumë sepse ishte shumë vonë për të përgatitur diçka tjetër...

Nëse do të ishit në të tilla rrethana, si do të vepronit me këtë gabim të bërë padashje? I lodhur nga puna e përditshme ktheheni në shtëpi dy orë me vonesë. Gruaja juaj e turpëruar dhe e shqetësuar ju përshëndet dhe thotë:

▫ Më fal, për shkak se ju erdhët me vonesë dhe meqë unë isha e zënë me punë, nuk e vura re sa shumë kish kaluar koha. Fatkeqësisht, nuk kam përgatitur asgjë për të ngrënë. Si do të ishte

reagimi juaj kundrejt kësaj ndodhie ndërkohë që jeni i uritur dhe i etur?

▫ Do të nevrikoseshit dhe do të thonit: Ke ndenjur kot, ku e ke pasur mendjen?!

▫ Hani e pini në shtëpi nga mëngjesi deri në darkë ndërsa unë duhet të tretem për një kafshatë bukë... Ah sikur të mos isha futur tani në këtë shtëpi të shkatërruar...!

I përplasni dyert me sa fuqi që kini dhe dilni jashtë duke e lënë vetëm gruan tuaj në kulmin e shqetësimit, e që kështu, këtej e tutje të ketë më shumë kujdes.

▫ Kur e shikoni se ajo është mjaft e shqetësuar, përpiqeni që të mos i bjerë në sy lodhja dhe uria juaj; vini buzën në gaz dhe i thoni: kjo nuk ia vlen të shqetësohesh. Sot do të hamë ushqim të gatshëm dhe nëse dëshiron, po shkoj të blej ushqim në dyqan. Nuk dua që për hir të kësaj ngjarjeje të shqetësohesh qoftë edhe për një çast.

▫ Do të ruanit gjakftohësinë dhe do të thonit: S'ka problem, tashmë çfarë kishte për të ngjarë- ngjau, dhe nuk është më e rëndësishme, mirëpo, megjithëse e dini se një gjë e tillë mund t'i ndodhë gjithkujt, do ta qortonit atë duke thënë: Bëj pak më tepër kujdes. Nëse do t'i

kishe planifikuar më mirë punët tuaja, nuk do të ndodhte një gjë e tillë etj, etj.

▫ Gjithësesi, do të vepronit në mënyrë të atillë, që veten ta paraqisnit të logjikshëm dhe bujar, por njëkohësisht, edhe gruaja juaj ta ndiente veten të turpëruar ndaj jush.

Nëse doni të jeni dëshmitar i përsosurisë në të tilla raste, lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 105 që të shikoni një botë të tërë këshillash, porosish dhe urtësish të përmbledhur vetëm në disa rreshta. Në tregimin e mëposhtëm sjellja fisnike e Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), është shembulli më i përkryer i jetës tonë kur ndeshemi me anëtarët e familjes dhe me miqtë tanë.

Hadith

I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ka thënë: ***“Më e forta prej lidhjeve të Islamit është që të duash për hir të Zotit dhe të urresh po për hir të Zotit.”***¹

Prova e zgjuarsisë

Deri në fund, asnjë nxënës nuk arriti t'i jepte përgjigje të saktë pyetjes që kishte drejtuar mësuesi. Secili dha përgjigjen e vet; mirëpo, asnjëra nuk ishte e saktë. Pyetja që u kishte drejtuar Profeti i nderuar shokëve të tij ishte: “Ndërmjet pikave kryesore të besimit, cila është më e forta? Njëri prej shokëve tha: “**Namazi.**”

Profeti i nderuar tha: “**Jo.**”

Tjetri, tha: “**Zeqati.**”

Profeti i nderuar tha: “**Jo**”

I treti tha: “**Agjërimi.**”

Profeti i nderuar tha: “**Jo.**”

I katërti tha: “**Haxhi dhe umra.**”

Profeti i nderuar tha: “**Jo.**”

I pesti tha: “**Xhihadi**” (Lufta e Shenjtë).

Profeti i nderuar tha: “**Jo.**”

¹ *Kenẓul Ummal, vëll. 1. faqe 43.*

Nëse atë ditë do të kishit qenë të pranishëm në mes të as'habëve [shokëve të Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!)], çfarë përgjigjeje do të jepnit:

- Urdhërimi për punë të mira dhe ndalimi nga punët e këqija.
- Të duash dhe të mos duash vetëm për hir të Zotit.
- Kryerja e bamirësisë, e cila është e dobishme për të gjithë.
- Të ndihmosh personat në nevojë.

Për të dëgjuar përgjigjen e saktë nga i Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 106.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: ***“Sa e bukur është ruajtja e ekuilibrit në kohëra kur s’jemi në nevojë. Sa e bukur është ruajtja e ekuilibrit në kohëra vobektësie. Sa e bukur është ruajtja e ekuilibrit në adhurim.”***

Ruajtja e ekuilibrit, madje, edhe në adhurim

Në ndodhinë e beni Kurejdhës, për shkak të pabesisë së çifutëve ndaj Islamit dhe ndaj myslimanëve, Profeti i nderuar (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) mori vendim që ta çojë punën e tyre deri në fund e të sqarojë gjërat përfundimisht. Çifutët i kërkuar Profetit që t’u dërgojë atyre Ebu Lebabem për t’u këshilluar me të. Profeti i nderuar (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) urdhëroi: “Shko o Ebu Lebabe!”

Ebu Lebabeja iu përgjigj urdhrit të Profetit dhe u ul me ata për t’u këshilluar; mirëpo nën ndikimin e marrëdhënieve të veçanta që ky kishte me çifutët nuk u përkujdes aq sa duhej për interesat e Islamit dhe të myslimanëve. Ai tha fjalë dhe shfaqti qëndrim në interes të çifutëve dhe në dëm të myslimanëve. Kur doli jashtë mbledhjes dhe kuvendit, e ndjeu që

kishte tradhëtuar, ndonëse askush nuk e dinte këtë; mirëpo, në çdo hap që hidhte në drejtim të Medines, zjarri i tradhëtisë ndizej edhe më fort në zemrën e tij. Arriti në shtëpi, jo për të parë gruan dhe fëmijët, por mori një litar me vete dhe u nis për në xhaminë e Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Aty e lidhi veten fort pas një kolone të xhamisë dhe tha:

- “O Zot, derisa pendimi im të mos pranohet, kurrë nuk do ta zgjidh veten nga kolona e xhamisë.” Kanë treguar se vetëm për faljen e namazit, nevojat personale dhe për të ngrënë bukë vinte e bija dhe e zgjidhte nga kolona dhe pasi mbaronte, lidhej sërish në kolonë dhe u zhyste në lutje dhe thoshte: “O Zot! Veprova gabim, O Zot! Kam bërë faj, O Zot! Kam tradhëtuar Islamin dhe myslimanët, o Zot! E kam tradhëtuar Profetin Tënd, O Zot! Derisa pendimi (teubeja) im të mos pranohet do të qëndroj në këtë gjendje derisa të vdes.” Ky lajm i arriti Profetit të nderuar (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!). Ai urdhëroi e tha: “Nëse do të kishte ardhur pranë meje dhe do ta pranonte dhe pohonte, do t'i kërkoja mëshirë dhe falje Zotit për të; mirëpo, ai shkoi vetë ta kërkojë këtë gjë prej Zotit, prandaj Zoti do të

përkujdeset vetë për të.” Nuk kishin kaluar më shumë se dy ditë nga kjo ndodhi, kur Profetit të nderuar i zbriti Shpallja në shtëpinë e Ummu Selemes, e nga ku Profeti prej kësaj shpalljeje u lajmërua se pendimi i këtij burri ishte pranuar. Pas kësaj, Profeti i nderuar tha: “O Ummu Seleme, u pranua pendimi i Ebu Lebabes.” Ummu Selemeja tha : “O i Dërguari i Zotit! A më jep leje që t’ia them unë këtë lajm të mirë Ebu Lebabes?” Profeti i nderuar iu përgjigj: “Mund t’ia thuash.” Dhomat e Profetit kishin secila nga një kapanxhë me drejtim nga xhamia dhe ato i kishin ndërtuar rreth e qark xhamisë. Ummu Selemeja nxori kokën jashtë kapanxhës dhe tha: “O Ebu Lebabe po të jap lajmin e mirë se Zoti e ka pranuar pendimin tënd.” Ky lajm gjëmoi si top në Medine. Myslimanët u derdhën brenda në xhami që ta zgjidhnin Ebu Lebabën nga litarët; mirëpo, ai nuk i lejoi dhe tha: “Mua zemra më dëshiron që këtë litar të ma zgjidhë Profeti i nderuar me duart e tij të bekuara.” Njerëzit erdhën pranë Profetit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), dhe i thanë: “O i Dërguar i Zotit, Ebu Lebabja ka kërkuar që ti t’ia zgjidhësh litarin.” Profeti shkoi dhe i zgjidhi litarin. Më pas urdhëroi e tha: “O Ebu Lebabe! Ty tu pranua pendimi.

Ti u pastrove aq shumë sa u bërë provë në domethënien e ajetit: “All’llahu i do të penduarit dhe të pastërtit.” Tashmë, ti je si fëmijë i porsalindur, prandaj nuk gjendet më as edhe një njollë gjynahi në ty.” Ebu Lebabja tha: “O i Dërguar i Zotit! Dua që në shenjë falënderimi ndaj kësaj mirësie, ta jap për sadaka (lëmoshë) të gjithë pasurinë time në rrugën e Zotit...”



Si mendoni? Fjalitë e këtij tregimi duhet të jenë një mësim për ne. Është mirë që të përpiqemi edhe ne në dhurimin e pasurisë për sadaka (lëmoshë). Nëse do të përballeshim me një kërkesë të ngjashme siç është propozimin e Ebu Lebabes, si do të përgjigjeshim?

▫ Jo, dhënia e gjithë pasurisë për sadaka (lëmoshë) nuk është një punë e drejtë sepse njëkohësisht, është i nevojshëm e sigurimi i shpenzimeve për përballimin e nevojave të ndryshme të jetës, madje, edhe gjatë dhënies së lëmoshës nuk duhet tepruar.

▫ Përballë kësaj mirësie (sadakasë) e gjithë pasuria nuk është asgjë. Nëse dikush vendos ta flijojë veten e tij përsëri është pak.

▫ Është një propozim i mirë që në shenjë

mirënjohjeje ndaj kësaj mirësisë së Zotit, të japë sadaka të gjithë pasurinë e vet dhe njëkohësisht deri në fund të jetës të angazhohet në adhurimin e Zotit të Madhëruar në ndonjë skutë larg njerëzve e që në këtë mënyrë të qëndrojë i pastër dhe të mos njolloset me gjynahe.

▫ Ai person që nuk ka bërë gjynahe, nuk nevojitet që të japë sadaka dhe t'ia falë plaçkat e veta të tjerëve; vetëm se, duhet të bëjë kujdes që të mos bjerë në gjynahe më vonë.

Për ta kuptuar përgjigjen që dha Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), ndaj propozimit të Ebu Lebabes lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 106.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: ***“Më i forti ndër ju, është ai që përmbahet dhe e vë nën kontroll veten e tij kur zemërohet, ndërsa më i durueshmi dhe më tolerant ndër ju, është ai i cili fal më shumë kur ka fuqi.”***¹

Gara e peshëngritjes

Disa të rinj myslimanë matnin forcën në garën e peshëngritjes. Ata po provonin se cili do të dilte fitimtar, duke u përpjekur ta lëviznin peshën në bazë të fuqisë që kishin. Në atë çast mbërriti Profeti i nderuar dhe pyeti:

- “Çfarë po bëni?”
- “Jemi duke matur forcën. Duam të shikojmë se kush prej nesh është më i forti.”
- “A keni dëshirë t’ua them unë se kush është më i forti nga të gjithë?” – pyeti Profeti.
- “Sigurisht, e ku ka më mirë se sa i Dërguari i Zotit të jetë gjyqtar i garës!”

Si mendoni, kush është më i forti?

▫ Ai, që vetëm me një lëvizje të ngrejë peshën më të rëndë.

¹ *Tubeful Ukul, faqe 45.*

- Ai, i cili ka krahë dhe shtat të fuqishëm.
- Ai që mund ta kontrollojë veten e tij kur përballët me gjërat e këqija dhe të shëmtuara.
- Ai, i cili me anë të fuqisë i flak tutje sheshit të ndeshjes të gjithë sfidantët.

Ashtu sikurse edhe do ta lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 107 do të të kuptoni se kush është më i forti përmes fjalëve të Profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!).

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: ***“Ai, i cili shkëputet nga gjithçka dhe lidhet me Zotin, Zoti do t’i plotësojë të gjitha nevojat që ka, ndërsa, ai, i cili (është shkëputur nga Zoti) i vihet pas kësaj bote, Zoti do t’ia lejë atë në dorë vetë kësaj bote”***.

Burri që kërkonte ndihmë

Ndërkohë që mendonte të kaluarën e tij plot vështirësi, iu kujtua se sa ditë të hidhura dhe plot mundime kishte lënë pas; ditë në të cilat nuk qe në gjendje që të sigurate as ushqimin e gruas dhe të të vegjëleve të pafajshëm. Ai po mendonte me vete se si ishte e mundur që një fjali e shkurtër dhe vetëm një fjali e cila gudulisi për vetëm tre herë vesin e tij, i fali fuqi shpirtit të tij dhe i ndryshoi rrjedhën e jetesës duke e shpëtuar atë dhe familjen e tij nga varfëria dhe mjerimi, peng i të cilave kishin qenë. Ai ishte njëri prej shokëve të Profetit. Mbi të mbizotëronte skamja dhe mjerimi. Një ditë, kur ai ndjeu se i kishte mbërritur thika në kockë, duke u këshilluar me të shoqen dhe propozimin e saj, vendosi që të shkonte e t’ia përshkruante gjendjen e vet të Dërguarit të Zotit dhe të kërkonte ndihmë ekonomike.

U nis me këtë qëllim, mirëpo, përpara se të thoshte hallin që kishte, dëgjoji këtë fjalë nga goja e Profetit të nderuar: Ne do të ndihmojmë këdo që kërkon ndihmë prej nesh, mirëpo, nëse dikush është në nevojë dhe mundohet që ta shmangë atë duke mos ia zgjatur dorën ndonjë krijese tjetër, Zoti i Madhëruar do ta bëjë atë që mos jetë më në nevojë. Atë ditë nuk tha gjë dhe u kthye në shtëpi. Sërish u përball me përbindëshin e tmerrshëm të varfërisë i cili kishte lëshuar hije në shtëpinë e tij. Në këtë shtrëngim e sipër, edhe ditën tjetër shkoi tek Profeti me të njëjtin qëllim, por edhe atë ditë ai dëgjoji të njëjtat fjalë nga goja e Profetit të nderuar. “Ne do të ndihmojmë këdo që na kërkon ndihmë, mirëpo, nëse dikush është në nevojë dhe mundohet që ta shmangë atë, Zoti i Madhëruar do ta bëjë atë që të mos jetë më në nevojë. Edhe kësaj here u kthye në shtëpi pa ia shprehur hallin që kishte Profetit. Por, sërish duke e parë veten të mbërthyer në kthetrat e varfërisë, të pamundësisë dhe të mjerimit, u nis për herë të tretë po me të njëjtin qëllim për të takuar Profetin e nderuar. Përsëri buzët e Profetit të nderuar zunë të lëvizin, dhe me atë melodi që i fal zemrës fuqi dhe i jep shpirtit siguri përsëritën të njëjtat fjalë...

Vendoseni veten në vendin e atij burri. Nga njëra anë, për të plotësuar nevojat më elementare të jetës jeni mjaft të varfër dhe nuk mund t'i përgjigjeni kërkesave që i takojnë bashkëshortes dhe fëmijëve; nga ana tjetër, keni mundësi të kërkonit ndihmë tek dikush që edhe nëse do t'i kërkonit diçka atij, do t'ju ndihmonte pa dashur t'ia dijë për falënderimin nga ana juaj, në mënyrë që ju të dilnit nga kjo gjendje. Si do të vepronit në këto kushte? Do të thoni:

▫ E çfarë problemi ka nëse për të zgjidhur problemin tim i drejtohem dikujt i cili ka mundësi ekonomike. Ia përshkruaj atij hallin tim dhe i kërkoj të më ndihmojë.

▫ Kam turp që t'i kërkoj atij ndihmë. Do të duroj derisa ta kuptojë vetë hallin tim, përmes hyrjeve e daljeve të shpeshta të mia.

▫ Përsëri do të përpiqem që ta siguroj dhe ta shtie në dorë vetë bukën e përditshme duke shpresuar në mëshirën e Zotit të Madhëruar. Nëse Ai e dëshiron këtë, edhe unë jam dakort. Ashtu sikurse për vite të tëra i kam duruar dhe përballuar këto vështirësi, përsëri do të duroj dhe nuk do t'i kërkoj askujt diçka përveç se Zotit të Madhëruar.

▫ Unë kam dinjitet, nuk lyp. Duhet që prej

çdo rrugë të mundshme të shtie para në dorë e që kështu të shpëtoj prej kësaj fatkeqësie. Thoni: “Stomaku i uritur nuk njeh as fe, dhe as besim (stomaku i uritur s’ka din e iman).” Të drejtën thonë: Deri kur do të rri e të mendoj për hallallin dhe për haramin (të lejuarën dhe të ndaluarën) dhe të mbetem i turpëruar në sy të gruas dhe fëmijëve.

Nëse do të lexojmë vazhdimin e tregimit në faqen 108 do të kuptojmë se cila është rruga e drejtë e cila bëhet motiv i kënaqësisë së të Dërguarit të Zotit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) dhe njëkohësisht, i fatbardhësisë sonë.

Hadith

I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ka urdhëruar:
“Kurdoherë që vjen tek ju më bujari i një populli, nderojeni atë!”¹

Djali i Hatemit

Përpara lindjes së Islamit dhe organizmit të shtetit islam, në mesin e arabëve ishte në fuqi zakoni i të jetuarit në fise ku secili kishte kryetarin e tij. Arabët e kishin bërë zakon të bindeshin dhe të dëgjonin prijësit e tyre, prandaj, herëpashere u paguanin atyre taksa e haraç. Njëri prej këtyre kryetarëve të fiseve arabe që shquhej për bujari ishte Hatem Taj, i cili njihej si prijësi i fisit Taj. Pas Hatemit zëvendës i tij u bë i biri, Adi. I gjithë fisi Taj iu bind atij me përlulësi. Ai çdo vit (qetë-qetë dhe me krekosje) i merrte secilit çerekun e të ardhurave si haraç dhe taksë. Udhëheqësia dhe pushteti i Adit përkoi me shfaqjen e Profetit të nderuar dhe me përhapjen e Islamit.

Fisi Taj ishin idhujtarë, mirëpo, vetë Adi ishte i besimit të krishterë e këtë besim e mbante të fshehtë prej popullit të vet. Arabët, të cilët ktheheshin në myslimanë, duke u njohur me mësimet liridhënëse të Islamit, dalëngadalë filluan të çliroheshin prej barrës së prijësve

¹ *Bihar el Envar, vëll. 74, faqe 180.*

të cilët iu kishin imponuar atyre bindjen. Pra, sipas gjithë kësaj, Adi i biri i Hatemit, ashtu si të gjithë aristokratët dhe kryetarit e tjerë arabë, e shikonte Islamin si rrezikun më të madh për veten dhe ushqente armiqësi ndaj Profetit. Mirëpo, tashmë, çdo punë kishte marrë fund. Njerëzit turma-turma zinin të pasonin Islamin, ndërsa çështja e Islamit dhe e myslimanëve kishte shkuar larg. Adi e dinte se do të vinte dita kur do t'i kërkonin të hiqte dorë nga sundimi i tij. Ai kishte një shërbëtor që mbante përherë gati pranë tendës së tij një grup devesh të majme dhe kafshësh të tjera të shëndetshme dhe në çdo moment që do të merrte vesh për afrimin e ushtrisë myslimane do ta lajmëronte atë. Një ditë ai shërbëtor erdhi dhe tha: “Ushtritë myslimane gjenden fare pranë.” Adi urdhëroi që të bëjnë gati devetë. Hipi mbi to familjarët e vet dhe po ashtu, ngarkoi mbi to çdo plaçkë dhe orendi e cila mund dhe ia vlente të ngarkohej dhe ia mbathi drejt Shamit, ku populli ishte të krishterë dhe të të njëjtit besim me të. Mirëpo, si pasojë e ngutjes së madhe, u shkujdes dhe harroi të merrte me vete edhe të motrën Sefanenë. Ushtria islame mbërriti aty ku kish qenë Adi para se t’ia mbathte. Të motrën e tij, Sefanenë, e morën me robërit e tjerë dhe e çuan në Medine dhe i treguan Profetit historinë e arratisjes së Adit. Jashtë xhamisë së Medines ishte një vend me katër

faje muresh jo të larta. Robërit i vendosen aty. Një ditë Profeti i nderuar po kalonte përpara atij vendi që të futej në xhami. Sefaneja e cila ishte një grua e kuptueshme dhe e gojës, lëvizi nga vendi dhe i tha Profetit: “Babai im më ka lënë, ndërsa kujdestari im është fshehur. Të lutem bëme nder, e Zoti të bëftë nder ty.” I Dërguari i Zotit e pyeti atë: “Cili është kujdestari yt?” Ajo i tha: “Adi, i biri i Hatemit.” Profeti (paqja dhe bekimet e All’llut qofshin mbi të) pyeti: “Mos është ai që u arratis ngaj Zoti dhe të dërguarit të Tij?!” Kaq tha Profeti i nderuar dhe menjëherë u largua nga aty. Të nesërmen erdhi sërish që të kalonte andej dhe Sefaneja u çua nga vendi dhe i tha të njëjtën gjë që i pat thënë ditën e shkuar; gjithashtu, edhe Profeti i nderuar i tha të njëjtat fjalë që i pat thënë ditën e mëparshme. Sërish edhe këtë ditë kërkesa e Sefanesë doli pa rezultat. Ditën e tretë, kur Profeti kaloi andej, Sefaneja nuk kishte më aq shumë shpresë se do t’i pranohej kërkesa, prandaj vendosi që të mos fliste asnjë fjalë; mirëpo, një djalë i ri që po i vinte nga pas Profetit ia bëri me shenjë asaj duke i dhënë të kuptojë që të lëvizë dhe t’ia përsërisë kërkesën Profetit. Sefaneja lëvizi dhe i tha ashtu siç i pat thënë edhe dy ditë më parë: “Babai më ka lënë, kujdestari im është fshehur, të lutem bëme nder, e Zoti të bëftë nder ty.” I Dërguari i Zotit tha: “Mjaft mirë, jam në pritje të gjinden njerëz të

besuar, e që të të dërgoj ty nën shoqërinë e tyre pranë fisit tënd. Nëse mëson se kanë ardhur të tillë persona në Medine, më çdo lajm.” Sefaneja, pyeti njerëzit të cilët gjendeshin atje: “Cili ishte ai person i cili po i vinte nga pas Profetit dhe që ma bëri me shenjë që të lëviz dhe t’ia ribëj kërkesën time?” I thanë se ai është Aliu, i biri i Ebu Talibit. Pas një farë kohe Sefaneja i çoi lajm Profetit se në Medine kishte ardhur një grup i besueshëm prej fisit të saj, prandaj I kërkoi ta dërgonte atë nën shoqërinë e tyre. Profeti i nderuar i dha asaj rroba të reja, një shumë të hollash për shpenzime dhe një kafshë bartëse dhe ajo e shoqëruar shkoi tek i vëllai në Sham. Sapo Sefanesë i kapën sytë Adin filloi ta qortonte dhe i tha: “Ti i more gruan dhe fëmijët e tu, ndërsa mua që jam kujtim i tyt eti më harrove e më le?!” Adi i kërkoi ndjesë asaj. Sefaneja ishte një grua e kuptueshme. Adi zu të këshillohej me të për punën e vet dhe i tha asaj: “Si mendon ti që e ke parë Muhammedin nga afër, cila është në të mirën time? A të shkoj e të bashkohem me të apo të vazhdoj e t’i largohem edhe më shumë.” Sefaneja tha: “Për mendimin tim është mirë që ti të bashkohesh me të, nëse me të vërtetë është i Dërguar i Zotit, atëherë lum për ty; nëse nuk është Profet dhe ka sekretin e të sunduarit, përsëri ti në atë vend, i cili nuk është shumë larg prej Jemenit, me reputacion dhe me personalitetin që gëzon

në mesin e popullit të Jemenit nuk do të përbuzesh dhe nuk do të humbësh nderin dhe lavdinë tënde.” Adit i pëlqeu ky mendim dhe vendosi që të shkojë në Medine dhe ndërkojë të shikojë hollësisht veprimtarinë e Profetit dhe duke pasur vëmendjen tek sjellja e tij; të shikojë nëse me të vërtetë ai është i Dërguar i Zotit, e që ta pasojë atë si njëri prej umetit, apo është një burrë që lyp dynjanë dhe ka sekretin e të sunduarit kështu, të bashkëpunojë e të shoqërohet me të në kufijtë e interesave të përbashkëta. Profeti ishte brenda në xhaminë e Medines kur hyri Adi dhe e përshëndeti Profetin duke i dhënë selam. Profeti i nderuar e pyeti: -“Cili jeni ju?”

- “Jam Adi, i biri i Hatemit” - iu përgjigj ai.

Nëse do ta ndienit veten të fuqishëm dhe befash do të shikonit përballë jush dikë i cili ka qenë armik i juaj prej kohësh, si do të silleshit? Si mendoni se ka reaguar i Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) kur ka takuar Adin, të birin e Hatemit?

▫ U dha urdhër shokëve të tij besnikë që menjëherë, ta arrestonin atë me qëllim që, të paguante për padrejtësitë e veta dhe t’ia rimerrnin atij të drejtat e të shtypurve dhe më

pas ta kthenin te fisi i vet.

▫ Me qëllim që t'i thyejë hundën dhe ta turpërojë do t'i ketë thënë me mospërfillje: 'Ti je ai, që je armiqësuar me mua dhe në vend që t'i të përqafoje Islamin dhe myslimanët ia mbathe, e harrove motrën tënde dhe u arratisë bashkë me shpurën tënde drejt Shamit.

▫ E la për një farë kohe në pritje dhe pastaj tha: Po të pranoj, por me kusht që tani në çast të kthehesh në mysliman; plaçkat, të cilat ia ke marrë popullit t'ia rikthesh dhe që këtej e tutje të bësh një jetë të thjeshtë si të gjithë të tjerët.

▫ Në kohën që vuri re se kryetari i fisit Taj dhe i biri i një burri bujar si Hatem Taj kishte udhëtuar gjatë për ta takuar atë, doli dhe e priti me respekt dhe më pas e ftoi në shtëpinë e tij derisa t'i jepej rasti që pas diskutimeve të vendoste nëse do të donte të bëhej mysliman.

Gjurmët e vërtetuara të sjelljes fisnike të Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të) do t'i vëmë re pasi të studiojmë vazhdimin e tregimit në faqen 110 dhe sa mirë do të ishte sikur edhe ne, ashtu si Adi, i biri i Hatemit t'i kushtojmë më tepër vëmendje përballjeve të Profetit dhe të përfitojmë prej tyre.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: “*Shejtani ka rrjeta dhe çarqe, prej të cilave, me të bërë mendjemadh ndaj mirësive të Zotit, nëpërmjet dhuratave të Tij, me të bërë që t’u mburresh robve të tjerë të Zotit dhe të ndjekësh epshet në rrugë të kundërta me ato të Zotit.*” ¹

Gara e vrapimit me deve

Myslimanët tregonin mjaft interes për garat e vrapimit me kuaj, me deve, garat e marrjes nishan me shigjeta dhe të tjera të ngjashme me këto, sepse Islami e kishte bërë traditë ushtrimin e detyrave ku përvetësimi dhe mjeshtëria e tyre ishin të domosdoshme për ushtarët. Profeti i nderuar, i cili ishte udhëheqësi i Bashkësisë Islame, merrte vetë pjesë në këto lloj garash dhe kjo ishte nxitja më e mirë që u bëhej myslimanëve, veçanërisht të rinjve për përvetësimin e arteve ushtarake. Deri në kohën që kjo traditë ishte e zakonshme dhe udhëheqësit e Islamit i nxitnin myslimanët në këto punë ruhej shpirti heroik, guximtar dhe ushtarak në shoqërinë Islame. I Dërguari i Zotit herë i hipte kalit dhe herë devesë dhe garonte së bashku me garuesit e tjerë. Ai kishte një deve e cila shquhej për vrapim të shpejtë dhe që kishte

¹ *Nehxhul Fesaha, f.391.*

fituar me çdo deve tjetër që kishte garuar. Pak nga pak, tek disa njerëz naivë (të padjallëzuar) filloi të krijohej mendësia se kjo deve ia kalon të gjithave për arsye se ishte deveja Profetit, prandaj nuk mund të gjendej deve tjetër në këtë botë që të matej me të, deri kur një ditë prej ditësh një beduin erdhi në Medine së bashku me deven e vet dhe pretendoi se ishte gati që të hynte në garë kundër devesë së Profetit. Shokët e Profetit, me besim të plotë vrapuan jashtë qytetit për të parë këtë garë interesante, veçanërisht për arsyen se Profeti kishte marrë përsipër që t'i hipte vetë devesë. Profeti i nderuar dhe beduini nisën të udhëtonin drejt pikës nga ku ishte rënë dakort që të nisnin garën dhe nga aty u lëshuan për garë...

Si mendoni se ishte përfundimi i kësaj gare, po reagimi i spektatorëve dhe këshilla e Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) ndaj tyre? Nëse do ta krahasojmë me garat e zakonshme (p.sh. futbollin) do të mund ta shpjegojmë më mirë atë:

▫ Një numër njerëzish në emër të tifozllëkut ndaj të kuqes apo blusë, të zezës apo të bardhës ose të një skuadre tjetër, të cilët u bënë dëshmitarë të një rezultati të kundërt me parashikimin që kishin bërë, zunë të kryejnë veprime të

pahijshme, filluan të gjuajnë, të thyejnë dhe të djegin rrugicave e lagjeve.

▫ Pas mbarimit të garës, pa shfaqur as edhe një lloj reagimi i varën kokat poshtë dhe indiferentë shkuan në punën e tyre sikur të mos kishte ngjarë asgjë.

▫ Filluan diskutime të nxehta në mesin e tifozëve dhe pa pasur vëmendjen tek thelbi i garës dhe qëllimi i saj, secili zuri të konsideronte tjetrin të mangët dhe të mbronte skuadrën që pëlqente.

▫ I vunë veshin këshillës së Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe në vend të nervozizmit, shqetësimit dhe punëve që ndjellin marrëzi, zunë të mendonin me urtësi dhe me qëllimin madhështor të këtyre lloj garave, që të përvetësojnë prej tyre mësimin dhe shembullin e jetës.

Studioni vazhdimin e tregimit në faqen 112 për të mësuar mbi rezultatin e kësaj gare dhe fjalët e mençura të Profetit të nderuar (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!).

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: ***“Një orë t’i hedhë sytë dijetari punës së tij madje, duke qenë i mbështetur në shtrat, është më mirë se sa shtatëdhjetë vjet adhurime që bën adhuronjësi.”***¹

Te dijetari

Një burrë nga ensarët shkoi te Profetit dhe e pyeti: “O i Dërguar i Zotit! Kam një xhenaze për të përcjellë e për ta varrosur dhe njëkohësisht më duhet të jem edhe në një kuvend dijeje, por koha nuk më premtton të jem i pranishëm në të dy vendet njëkohësisht, sepse në cilëndo prej këtyre po të shkoja do të humbisja tjetrën, ju lutem më këshilloni në cilin nga këto vendeve të shkoj?”

Çfarë përgjigjeje do t’i jepnit kësaj pyetjeje?

▫ Të merrnit pjesë në përcjelljen e xhenazes së besimtarit sepse ajo është respekt ndaj tij dhe respekti ndaj besimtarit është i domosdoshëm.

▫ Të merrnit pjesë në përcjelljen e xhenazes, gjë

¹ Biharul Envar, vëll 2, faqe 23.

e cila bëhet shkak për ngushëllimin e zemrave të familjarëve të tij dhe më vonë nuk do t'i ngelet hatri.

▫ Nëse gjenden persona që do ta përcjellin xhenazen dhe ta fusin në tokë, atëherë pjesmarrja në kuvendin e dijes është më e mirë për ju.

Pas përzgjedhjes së njërës prej përgjigjeve, studioni vazhdimin e tregimit në faqen 113.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: “***Betohem në Zot! Nëse do të dinit atë që di unë, do të qeshnit pak e do të qanit shumë.***”¹

Në shtëpinë e Ummu Selemes

Atë natë i Dërguari i Zotit ishte në shtëpinë e Ummu Selemes. Ishte mesi i natës kur Ummu Selemeja u zgjua nga gjumi dhe vuri re se Profeti nuk ishte në shtrat. U shqetësua dhe mendoi vallë çfarë mund të kishte ngjarë?! U ngrit nga vendi dhe zuri ta kërkonte Profetin, dhe e pa atë tek po qëndronte në një qoshe të errët me duart të ngritura lart nga qielli dhe duke derdhur lot po thoshte: O Zot! O Zot, të lutem mos m’i merr gjërat e mira që m’i ke dhuruar. O Zot! Të lutem mos bëj që armiqtë dhe ziliqarët të gëzohen me vuajtjet dhe mërzinë time. O Zot ! Të lutem, mos më kthe mua drejt të këqijave, kur ndërkohë më ke shpëtuar prej tyre. O Zot, të lutem mos më lërë kurrë vetëm, qoftë edhe për një çast. Me të dëgjuar ato fjalë dhe duke parë në ç’gjendje ishte Profeti (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), Ummu Selemes i hynë të dridhura në trup...

¹ *Biharul Anuar, vëll. 55, f. 107.*

Si mendoni, pse u shqetësua Ummu Selemja dhe pse i hynë të dridhurat?

▫ Nga ndjesia e kuriozitetit dhe ngaqë ndoqi Profetin (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) fshehtaz?

▫ Nëse Profeti që ishte i Dërguar i Zotit po derdhte lot në këtë mënyrë nga frika e të Madhit Zot, atëherë çfarë detyre mbetej për njerëzit e thjeshtë që ta kënaqin Zotin e Madhëruar?

▫ Ngaqë kishte frikë se mos Profeti do ta kuptonte praninë e saj dhe do ta qortonte atë për këtë shfaqje kurioziteti.

Është më mirë që ta lexoni me kujdes vazhdimin e tregimit në faqen 114 dhe t'i rishikoni këto alternativa.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka urdhëruar: ***“Bëni qëndresë në rrugë të Zotit dhe sa mirë është që të jemi të këtillë.”***¹ ***“Bëj qëndresë dhe ji i moralshëm me njerëzit.”***²

Fjala që i dha fuqi Ebu Talibit

Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), pa i kushtuar rëndësi pasojave, me një këmbëngulje të çuditshme po rezistonte përballë kurejshëve dhe po i jepte vazhdimësi rrugës së vet drejt objektivave që kishte. Ai nuk nguronte të poshtëronte idhujt, ta quante të mangët arsyetimin e idhujtarëve dhe t'i konsideronte të humbur baballarët dhe gjyshërit e tyre. Paria e kurejshëve u zunë ngushtë. Ia parashtruan çështjen Ebu Talibit dhe i kërkuan atij që ta ndalte vetë djalin e vëllait të vet ose të linte kurejshët që ta ndalin atë. Ebu Talibi me një gjuhë të butë i qetësoi kurejshët, derisa kjo punë zuri të shkojë edhe më tej aq sa kurejshët nuk mund ta duronin më. Në çdo shtëpi flitej për Muhammedin (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe çdo dy veta që puqeshin bashkë zinin të përmendin me shqetësim fjalët dhe sjelljet e tij dhe faktin se si njerëzit vinin e ktheheshin

1 *Sunen ibn Maxbah, vëll. 1, f. 102.*

2 *Nebxhul Fasaha, f. 32.*

në ndjekës të tij nga çdo cep e anë, një e nga një apo grupe-grupe. S'kishte vend më për vonesë. Të gjithë njerëzit ranë dakort që sido që të jetë, duhej që ky shqetësim të merrte fund. Morën vendim që të bisedojnë edhe një herë me Ebu Talibin rreth kësaj çështjeje dhe kësaj rradhe t'i flasin atij me seriozitet dhe të jenë më të vendosur. Paria e kurejshëve shkuan tek Ebu talibi duke i thënë: “Ne të kërkuam ty që ta ndalje djalin e vëllait tënd, mirëpo, ti nuk e ndale atë. Neve nuk e ngamë atë përpara se ta parashtronim çështjen ty për hir të respektit që kemi dhe si burrë plak që je, por tani nuk do të tolerojmë më që ai të qeshë me mendjet tona dhe t'i quajë të humbur baballarët tanë. Kësaj here erdhëm për të të dhënë ultimatum, që nëse nuk e ndal djalin e vëllait tënd, atëherë ne nuk do ta marrim në konsideratë më shumë se kaq respektin dhe moshën tënde të thyer, dhe do të hyjmë në luftë si me ty ashtu edhe me atë derisa njëra palë të heqë dorë.”

Si e parashikoni përfundiminin e këtij kërcënimi? Si ju përgjigj hazreti Ebu Talibi kërcënimeve të parisë së kurejshëve?

▫ U dha fjalën atyre që sido që të ishte do t'ia mbushte mendjen djalit të vëllait të tij që të

hiqte dorë nga propagandimi i fesë së vet dhe që pas kësaj të mos i shkaktonte më shqetësime kurejshëve.

▫ U tha atyre: Muhammedi nuk heq dorë nga thirrja e vet dhe unë gjithashtu, sa të jem gjallë do të jem ndihmësi dhe mbështetësi i tij, ndërsa ju bëni çfarë të doni.

▫ E bëri me dije Profetin mbi kërcënimet e kurejshëve dhe për shkak se Profeti e pa në rrezik jetën e vet dhe të xhaxhait të tij, u dha atyre një përgjigje pozitive dhe në një kohë më të përshtatshme do t'i niste përsëri aktivitetet e veta.

▫ I propozoi Profetit të nderuar që të përmbahej ndaj vijimësisë së punës së vet, mirëpo, në kohën që Profeti iu përgjigj: “O xhaxha i dashur! Sa të jem gjallë nuk do të heq kurrë dorë edhe në qoftë se do të jap jetëm time në krye të kësaj pune”. Ebu Talibi i tha: O djali i vëllait tim! Edhe unë do të të mbroj ty deri në frymën e fundit.

Duke studiuar vazhdimin e tregimit në faqen 115 do të kuptoni se cila qe përgjigja që i dha Profeti propozimit të krerëve të kurejshit gjë e cila bëri që t'i dhurojë përsëri fuqi hazreti Ebu Talibit.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: “***Kurdoherë që dikush di diçka të vërtetë, frika prej njerëzve nuk duhet ta pengojë të thotë atë të vërtetë.***” ¹

Logjika e Profetit

Njëra nga bashkëshortet e Profetit që e quanin Marije Kobtije, lindi një djalë të cilin Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) e quajti Ibrahim. Profeti i nderuar zuri dashuri të madhe pas këtij djali, mirëpo, ende pa i kaluar tetëmbëdhjetë muaj nga lindja, ky vogëlush ndërroi jetë. Profeti i nderuar që ishte shumë i ndjeshëm dhe i dashur u prek mjaft nga kjo fatkeqësi, derdhte lot dhe thoshte: “O Ibrahim! Zemra digjet dhe rrjedh lot dhe ne jemi të trishtuar për ty, por kurrë nuk do them gjë kundër vullnetit të Zotit.” Të gjithë myslimanët u preken nga kjo tragjedi, sepse ata e kishin vënë re se zemrën e Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) e kishte mbuluar pikëllimi. Atë ditë për fat qëllloi që dielli të ishte i zënë (kohë e vranët). Me vështrimin e kësaj gjendjeje, myslimanët të gjithë së bashku u shprehen se: “zënia e diellit është një harmoni e botës qiellore me botën tokësore dhe të Dërguarin e Zotit, prandaj kjo

¹ *Kenzul Ummal*, vëll. 3, f. 76.

që ndodhi nuk mund të jetë asgjë tjetër përveç se për hir të vdekjes së të birit të Profetit.” Sigurisht, që kjo çështje nuk has pengesë në vetvete, por, gjithashtu, për hir të të Dërguarit të Zotit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), është e mundur që bota të kthehet së prapthi (të përmbysset), por në atë kohë kjo rastësi nuk ishte për atë gjë dhe realisht ishte një çështje e zakonshme. Meqë populli po i vinte re këto dy rastësi në të njëjtën ditë i pandehën të lidhura me njëra-tjetrën dhe së fundmi, u bë shkak që atyre t’u rritej besimi lidhur me të Dërguarin e Zotit. Kjo çështje arriti në vesh të Profetit të nderuar (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të).

Nëse do të zotëronit ndonjë pozitë dhe do të përballeshit me një rast të tillë, si do të vepronit? Do të shfrytëzonit këtë rast për të mirën dhe qëllimin tuaj dhe nuk do t’i kushtonit vëmendje saktësisë apo pasaktësisë së saj apo...

▫ Për t’u paraprirë abuzimeve të të tjerëve, do të shfaqnit haptazi se përkundër besimit të krijuar në popull kjo ngjarje është diçka e natyrshme dhe nuk lidhet me ju.

▫ Në kohën që do të vinit re se nga kjo ngjarje besimi i njerëzve në raport me ju është shtuar

edhe më shumë do të heshtnit dhe do të shfaqnit një reagim.

▫ Do të kërkonit situatën e përshtatshme dhe do të përfitonit prej ndjesive dhe ndjenjave të njerëzve për propagandimin në interesin tuaj.

▫ Do të thonit që populli po të ndjekë këtë rrugë, do të besonin më tepër se sa ata që ndjekin rrugën e arsytimit dhe të logjikës, atëherë është më mirë që t'i përforcojmë dhe t'i përhapim këto thashetheme e kështu një numër më i madh njerëzish të priren për nga çështjet fetare. Objektivi është parhapja e fesë. Në çdo mënyrë që kryhet përhapja e fesë prapseprap mirë është.

Nëse do të donit të dinit se si u përball Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të) me këtë incident dhe këto thashetheme, lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 116.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: “***Çdokujt që është i butë, i qetë dhe i shtruar, Zoti i bën haram djegjen në zjarrin e Xhehenemit.***” ¹

Mësuesi më i mëshirshëm

Muavije ibn Hakem tregon: Ishim duke falur namaz kur dikush teshtiu. Unë si zakonisht thashë: All’llahu të mëshiroftë! Të gjithë panë nga unë mirëpo, nuk e kuptova arsyen. Burri teshtiu përsëri dhe unë sërish i thashë: All’llahu të mëshiroftë! Por kur vura re se sërish të gjithë njerëzit kthyen kokën nga unë, u inatosa dhe u ngrita e thashë: Ja qaftë kokën e ëma! E pse më shikoni?!

Ata që po faleshin më dhanë shenjë me dorë që të hesht dhe unë heshta. Ndërkohë mbaroi namazi dhe i Dërguari i Zotit më afroi pranë...

Nëse do të kishit qenë prej atyre që faleshin atë ditë si do të kishit vepruar?

▫ Do ta gjykonit dhe do ta qortonit ashpër atë që flet në namaz dhe pse përdor fjalë të këqija.

▫ Do ta qortonit atë në sy të të tjerëve që si

¹ Nexhul Belaga, faqe 315.

ka mundësi që në këtë moshë ende nuk njih rregullat e namazit dhe gjithashtu, nuk e di se të flasësh e prish namazin.

▫ Me një ton të butë dhe të qetë, në mënyrë që të tjerët të mos e kuptojnë edhe aq shumë, do t'i thonit: Bëj kujdes! Për shkak se ti fole, namazi yt nuk është i saktë.

A e dini se çfarë i tha Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), kur e thirri?!

Lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 118.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka thënë: ***“Sa herë që Zoti e di që një rob i Tij është penduar për gjynahin e vet, ia fal gjynahin atij ende pa i kërkuar falje.”***¹

Profeti i mëshirës

Hazreti Aliu ka thënë: “I Dërguari i Zotit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), më ka urdhëruar mua, Zubejrit dhe Mikdadit: ‘Lëvizni sa më shpejt dhe shkoni me nxitim në vendin e quajtur Rouze Khah! Atje do të vini re një samar deveje mbi të cilin rri një grua e cila me vete ka një letër. Merrjani letrën asaj dhe sillmani.’” Ne lëvizëm dhe nxitimthi arritëm në vendin e quajtur Rouze Khah. Aty pamë një samar të madh deveje mbi të cilin rrinte një grua. E zbritëm atë poshtë dhe i thamë:

- “Na e dorëzo letrën që ke me vete!”

Ajo u përgjigj: - “Unë nuk kam asnjë letër me vete.”

- I thamë: “Sigurisht, që ke me vete një letër, prandaj ose na e dorëzo atë, ose do të të vrasim ose do të të zhveshim që ta gjejmë atë.” Duke mos pasur se nga t’ja mbante, e nxori letrën

1 Al mustedrek alas-salilujn, vëll. 40, faqe 253.

që e kishte fshehur pas flokëve të saj të gjata dhe na e dorëzoi. E morëm letrën dhe ia dorëzuam të Dërguarit të Zotit. Ai e hapi atë letër dhe ne vumë re se ajo letër ishte shkruar nga Hatib ibn Ebi Belata në adresë të një grupi të idhujtarëve të Mekkes, në të cilën ai u kishte shpalosur idhujtarëve një sekret ushtarak të myslimanëve. I Dërguari i Zotit e thirri Hatibin për t'u paraqitur...

Nëse do të ishit në atë pozitë ku do t'u duhej të merrnit vendimin ndaj gjykimit të Hatibit, si do të vepronit?

▫ Do të thonit: Ekzekutojeni menjëherë këtë spiun, e që askush tjetër të mos guxojë më që t'i shpalosë sekretet ushtarake të myslimanëve për armiq të.

▫ Do ta gjykonit atë dhe duke mos i kushtuar aspak vëmendje mbrojtjeve që ai i bën vetes, do të jepnit urdhër që të ekzekutohej.

▫ Nëse kuptonit se në mbrojtjen që i bën vetes, ai flet sinqerisht dhe ju parashtrohet një shfaqje të pranueshëm, do ta falnit atë.

▫ Do t'i thonit: Megjithëse shtron argumenta për veprimet e tua dhe e dimë se ke marrë pjesë edhe në luftën e Bedrit dhe luftoje përkrah

ushtrisë së Profetit, gjynahi yt është aq i madh saqë nuk mund të falet.

Për të mësuar se si u soll Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) me Hatibin dhe pse hazretin e tij e quajnë Profeti i mëshirës, lexoni vazhdimin e tregimit në faqen 118.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka urdhëruar:
“Lërxani dynjanë të zotëve të saj (atyre që e duan dhe mos e lidhni zemrën me të) sepse çdokush që merr prej saj diçka më shumë sesa masa e duhur, përpiqet me pavetëdiqe për shkatërrimin e vet.”¹

Fatkeqësia (belaja) e pasurisë

Tha'lebe ibn Hatib ishte një nga ensarët dhe një burrë i varfër, i cili vinte rregullisht në xhaminë e Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe këmbëngulte që Profeti të lutej për të që Zoti t'i dhuronte atij pasuri të bollshme. Profeti i tha atij: “Pasuria e paktë, të cilës mund t'ia paguash të drejtën e saj (zekatin ose humsin) është më e mirë se sa pasuria e madhe, të cilës nuk mund që t'ia shlyesh të drejtën e saj.” A nuk do të ishte më e mirë që ti të ndiqje shembullin e të Dërguarit të Zotit dhe të bëje një jetë të thjeshtë?” Mirëpo, Tha'lebjja nuk hiqte dorë. Një ditë i tha Profetit se betohej, se nëse Zoti do të tregonte dashamirësi e t'i jepte pasuri, do t'i paguante dhe t'i shlyente të gjitha të drejtat e asaj pasurie.

¹ *Nebxhul Fasaha*, f. 554.

Më në fund, Profeti u lut për të...

Në kohën që meditoni rreth pasurisë, në çfarë përfundimi arrini?

▫ E shikoni të mjaftueshme gjendjen aktuale ekonomike dhe mendoni se nuk është e nevojshme që të përpiqeni edhe më tepër për përmirësimin e saj.

▫ Dëshironi që pa u munduar t'ju vijë në duar një pasuri e paparashikuar që t'ju plotësojë të gjitha dëshirat tuaja.

▫ Me punë dhe përpjekje mundohuni që të keni të ardhura të mjaftueshme, mirëpo kujdes, që ta vini pasurinë në mënyrë të atillë nën kontroll që të mund ta shpenzoni në udhën e kënaqësisë së Zotit dhe jo ta jeni në dispozicion të pasurisë (të vareni nga pasuria).

▫ Lumturinë dhe fatbardhësinë më shumë se në çdo gjë tjetër e shikoni tek pasuria dhe e konsideroni atë si zgjidhje e të gjitha problemeve.

Pasi të keni studiuar vazhdimin e tregimit në faqen 119 duhet të mundohemi që duke përfutur prej fjalës së Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), të ndjekim rrugën e drejtë.

Hadith

I Dërguari i Zotit ka urdhëruar: “***Mos shikoni sa i vogël është gjynahi por, hapni sytë se ndaj cilit person keni guxuar të bëni veprime të pahijshme.***”¹

Mbledhja e shkarpave në shkretëtirë

Në një prej udhëtimeve me shokët e tij i Dërguari i Zotit zbriti në një tokë të shkretë pa bar. Ata kishin nevojë për shkarpa për zjarrin, prandaj Profeti (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) urdhëroi: “Mblidhni shkarpa!” Shokët thanë: “O i Dërguar i Zotit, shikojeni se sa i zbrazët është ky territor, ku nuk duket asnjë shkarpë.” Profeti tha: “Çdokush të mbledhë aq sa të mundë.” Shokët u shpërndanë nëpër shkretëtirë. Ata shikonin me kujdes përmbi tokë dhe nëse hasnin në degë të vogël e shkulnin atë. Secili mblodhi ca e nga ca aq sa mundi dhe i solli me vete. Kështu, u grumbullua një turrë e madhe shkarpash. Në këtë kohë, Profeti i nderuar tha: “Edhe gjynahet e vogla janë si këto shkarpat e vogla...”

¹ *Biharul Anuar, vëll. 74, f.170.*

Nuk keni menduar asnjëherë mbi këtë temë?
Me cilën nga përgjigjet e mëposhtme është më
i përafërt mendimi juaj?

▫ Deri tani nuk kam menduar ende mbi këtë
temë.

▫ Njeriu duhet të përmbahet dhe ta frenojë
veten prej gjynaheve të mëdha, ndërsa për
gjynahet e vogla s'ka gjë.

▫ Pavëmendja ndaj gjynaheve të vogla është
vetë një gjynah i madh, sepse sikur gjynahet e
vogla të mblidhen së bashku bëhen shumë.


Studioni vazhdimin e tregimit në faqen 121.

Vazhdimi i tregimeve

“Burri që kërkoi këshillë”

(vijon nga faqja 20)

... Burri mendoi me vete se tani ishte momenti i duhur që ta vërë në jetë atë fjalinë e shkurtër që i tha Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) - “Mos u zemëro!”. Doli përpara dhe thirri pranë shefin e krahut matanë dhe pyeti: “Për çfarë është gjithë kjo grindje? Nëse qëllimi është për shkak të dëmshpërblimit të atij sulmi që kryen të rinjtë tanë të pamatur, unë jam gati që të paguaj prej mallit tim. Nuk ka arsye që për kaq pak gjë të derdhim gjakun e njëri-tjetrit.” Pala përballë kur dëgjoji fjalët e tij të mençura dhe të lidhura me bujarinë e tij, iu prek nderi dhe burrëria dhe thanë: “Edhe ne nuk jemi më pak se ti. Meqë puna është kështu, ne po heqim dorë nga pretendimet tona.” Kështu, të dy palët u kthyen drejt fiseve të tyre.¹




¹ “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 31, nga Usul Kafi.

“Beduini dhe Profeti Muhammed”

(vijon nga faqja 22)

... Shokët e Profetit u zemëruan jashtë mase, prandaj nuk kishte mbetur gjë tjetër përveçse të mësynin atë, mirëpo i Dërguari i Zotit i pengoi. Më pas, Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të), e mori me vete beduinin në shtëpinë e tij dhe e ndihmoi atë me një shtesë tjetër. Ndërkaq, arabi vuri re nga afër që gjendja e Profetit të nderuar nuk kishte ngjashmëri me gjendjen e prijësve dhe pushtetarëve që kish parë dhe se atje nuk ishte grumbulluar as flori dhe as mall. Beduini shprehu kënaqësinë dhe shqiptoi fjalë falënderuese. Në këtë kohë, Profeti i tha atij: “Ti dje shqiptove fjalë të ashpra dhe të vrazhda të cilat u bënë motiv i zemërimit të shokëve të mi, ndërsa tani, në praninë time the këto fjalë falënderuese dhe kam frikë se mos të ndodh ndonjë dëm nga ana e tyre. A do të mundesh vallë që t’i thuash po këto fjalë në prani të shokëve të mi, e që kështu të shmangësh zemërimin e tyre? Arabi pranoi. Të nesërmen arabi erdhi në xhami, në kohën kur ishin mbledhur të gjithë. Profeti i nderuar u kthye nga turma e njerëzve dhe tha: “Ky burrë ka ardhur të na thotë se është i kënaqur prej nesh, vallë të jetë kështu?” Beduini tha: “Kështu është!” Ai përsëriti fjalinë e falënderimit që i kishte thënë Profetit. Shokët e Profetit (paqja

dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) zunë të qeshnin. Në këtë kohë, i Dërguari i Zotit iu drejtua shokëve e tha: “Shembulli im me këtë kategori individësh, është si i atij burrit që i ishte trembur dhe ia kishte mbathur deveja. Njerëzit duke dashur ta ndihmonin të zotin e deve, filluan të bërtisnin dhe ta ndiqnin me vrap devenë, kurse ajo deve e shtonte edhe më tepër vrapin në rrëmujë që t’ja mbathte. I zoti i deve u thërret me zë të lartë njerëzve dhe u thotë: ‘Ju lutem shumë mos u merrni me devenë time, unë vetë e di më mirë se në ç’mënyrë ta zbus devenë time.’ Sapo që i ndaloj njerëzit nga ndjekja, vajti dhe shkuli një tufë bar e qetësisht iu afrua nga përpara deve. Pa patur nevojë t’i thërriste e t’i bërtiste, në kohën që i tregoi barin deveja u afrua e më pas me mjaft lehtësi e zuri për freri deven e vet dhe u largua. Nëse unë do t’ju kisha lënë të lirë dje, patjetër që ky beduin i mjerë do të ishte vrarë nga duart tuaja, - dhe në çfarë gjendjeje të keqe do të ishte vrarë, në gjendje të kufrit (mohimit të Zotit) dhe idhujtarisë - prandaj e pengova ndërhyrjen tuaj dhe vetëm me të mirë dhe me butësi e zbuta.”²



2 “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 24, nga Kehal el Basr.

“Mëshira dhe dashuria”

(vijon nga faqja 24)

... Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të), u shqetësua aq shumë nga këto fjalë saqë fytyra e tij e bekuar u skuq dhe u ndez flakë dhe në atë çast urdhëroi: “Ai njeri që nuk ka mëshirë për të tjerët, Zoti po ashtu nuk do të ketë mëshirë për të. Profeti pastaj shtoi: ‘E, çfarë të bëj unë nëse Zoti e ka shkukur mëshirën nga zemra jote?!’”³



“Falja në kohën e fuqisë”

(vijon nga faqja 26)

...Myslimanët deshën ta flaknin tej çifutin ose ta rrihnin. Por Profeti urdhëroi: “Jo, e di unë se çfarë bëj me mikun tim. Ju nuk keni punë.” Dhe, u soll aq butësisht sa çifuti po në atë vend tha: “Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç All'llahut dhe dëshmoj se ti je i Dërguar i Zotit. Juve duke pasur të këtillë fuqi arrini të duroni

³ “Jetëshkrimi dhe fjalët e Profetit të nderuar”, faqe 132, nga Njeriu i përsosur.

gjithë këto gjëra dhe ky nuk është durim i një njeriu të thjeshtë, prandaj padysim që jeni i Dërguar nga ana e Zotit.”⁴



“Ushqimi i përbashkët”

(vijon nga faqja 28)

... Profeti i nderuar tha: “E di që ju i kryeni, mirëpo Zoti nuk pëlqen që ta shohë robin e Tij në mes miqsh në një situatë të privilegjuar ku ky i bën privilegje vetes së vet kundrejt të tjerëve.”

Pastaj, shkoi drejt shkretëtirës, ku mbledhi një masë të nevojshme shkurresh e shkarpash dhe u kthye.⁵



⁴ “Jetëshkrimi dhe fjalët e Profetit të nderuar”, faqe 169, nga *Jetëshkrimi i Profetëve*.

⁵ “Tregime për njerëzit e vërtetë”, f. 12, nga *Kehlul Basar*.

“Fqinji i ri”

(vijon nga faqja 30)

... Profeti i nderuar, ngarkoi katër persona: Aliun, Selmanin, Ebu Dherrin dhe personi tjetër (kanë thënë se ka qenë Mikdadi) që me zë të lartë në xhami parpara të gjithëve, burrave e grave t’ju komunikonin që “kushdo qoftë ai, nga dëmi i të të cilit, fqinjët nuk ndihen të sigurt, nuk ka besim”. Ky njoftim u përsërit tre herë radhazi. Pastaj Profeti i nderuar, bëri me dorë nga të katër anët dhe tha: “Nga çdo anë llogaritet deri në dyzet shtëpi fqinjësh”.⁶



“I mjeri dhe pasaniku”

(vijon nga faqja 33)

...Profeti, i cili po e vinte re sjelljen e burrit të pasur iu drejtua atij dhe i tha: “U trembe se mos të ngjitet gjësend prej varfërisë së tij?!”

- “Jo, o i Dërguar i Zotit!”

- “U trembe se mos depërton ndonjë gjë prej pasurisë tënde te ai?!”

- “Jo, o i Dërguar i Zotit!”

6 “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 193, nga Usul Kafi.

- “Atëherë, pse u shmange dhe e shtyve tutje?”

- “E pranoj se kam bërë faj. Tani jam gati që për kompesim e këtij faji dhe për shlyerjen e këtij gjynahi t’i fal gjysmën e pasurisë time këtij vëllait tim mysliman ndaj të cilit e kreva gabimin.”

Burri i veshur me rroba të lekosura tha:

- “Unë nuk jam i gatshëm ta pranoj.” Njerëzit e pranishëm thanë: “Po pse?”

- “Sepse kam frikë se mos ndonjë ditë më bën mendjemadh dhe unë të sillem po me atë mënyrë me ndonjë vëlla mysliman sikurse u soll sot ky me mua.” ⁷



“Xhujberi dhe Zelfa”

(vijon nga faqja 35)

... Zijadi e ktheu Xhujberin me respekt në shtëpi dhe nxitoi vetë për te Profeti. Sapo e pa atë tha:

- “O i Dërguar i Zotit! Xhujberi erdhi në shtëpinë tonë dhe më solli të këtillë lajm prej jush. Traditat dhe zakonet tona në fuqi janë të

⁷ “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 62, nga Usul Kafi.

këtitlla që vajzat tona ua japim vetëm atyre që kanë pozitë të njëjtë me ne dhe që janë prej fisit tonë, të cilët janë ensarët dhe shokët tuaj.”

Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) tha: “O Zijad, Xhujberi është besimtar, ato pozita të cilat ty po t'i merr mendja sot, janë zhdukur. Burri besimtar i përket pozitës së gruas besimtare. Zijadi u kthye në shtëpi dhe shkoi përnjëherë tek e bija, Zelfa dhe i tregoi ngjarjen. -“Për mendimin tim mos e refuzo propozimin e Profetit. Çështja më përket mua. Sido që të jetë Xhujberi, unë jam ajo që duhet të jem e kënaqur. Përderisa i Dërguari i Zotit është dakort me këtë punë edhe unë jam dakord.” Babai e martoi Zelfën me Xhujberin. E caktoi mehrin e tij prej plaçkës së vet dhe i parapërgatiti pajë të mirë nuses. Xhujberin e pyetën:

- “A e ke marrë parasysh shtëpinë se ku do ta fusësh nusen?”

- “Unë, e vetmja gjë për të cilën kurrë nuk kisha menduar, ishte se vallë do vinte ndonjëherë ndonjë ditë që unë të kisha grua dhe jetën time. Profeti erdhi papritur e më tha ashtu e kështu dhe më dërgoi mua në shtëpinë e Zijadit.” Zijadi e përgatiti vetë shtëpinë dhe orenditë shtëpiake, plus dy veshje të përshtatshme për dhëndrin dhe e çoi nusen në atë shtëpi të zbukuruar, të parfumosur dhe të stolisur. U errësua dhe ra nata, Xhujberi nuk e dinte se

ku gjendej shtëpia që ishte gatitur enkas për të. Xhujberin e shpunë në atë shtëpi. Sapo që i panë sytë gjithë atë shtëpi dhe gjithë ato plaçka, dhe atë nuse aq të bukur iu kujtua e kaluara. Mendoj me vete: "...Unë isha një njeri i varfër dhe i huaj kur hyra në këtë qytet dhe nuk kisha asgjë, as mall dhe as bukuri, as familje dhe as farefis. Zoti m'i bëri të mundura mua të gjitha këto mirësi. Ja pra, ky është Islami që i ka dhënë kaq shumë ndryshim njerëzve që kurrë nuk ta merrte mendja. E pra, sa shumë duhet ta falënderojmë Zotin." Në atë çast atij i lindi një ndjenjë kënaqësie, mallëngjimi dhe falënderimi për Zotin e Lartësuar. Shkoi drejt e në një qoshe të dhomës dhe filloi të këndojë Kur'an dhe të falej. Ai erdhi në vete vetëm kur veshët i dëgjuan ezanin e namazit të sabahut. Atë ditë në shenjë falënderimi, Xhujberi vendosi ta agjëronte. Kur gratë shkuan të shihnin Zelfën e gjetën atë të virgjër dhe të pa zënë me dorë. U bë e qartë se Xhujberi aspak si ishte afruar asaj. Këtë gjë e mbajtën të fshehtë për Zijadin. Kaluan edhe dy ditë dhe netë të tjera po në këtë mënyrë. Xhujberi ditën agjëronte ndërsa natën falej dhe lexonte Kur'an. Pak nga pak te familja e nuses filloi të lindte mendimi se mos Xhujberi është i paaftë seksualisht dhe nuk kishte nevojë për femër. Të detyruar ia treguan çështjen vetë Zijadit. Zijadi e informoi Profetin rreth çështjes. Profeti e thirri Xhujberin dhe i

tha:

- “Vallë, tek ti nuk ekziston dëshira për grua?!”

- “Për fat kjo dëshirë është shumë e ndezur tek unë.”

- “Atëherë, përse nuk i je afruar nuses deri tani?”

- “O i Dërguar i Zotit! Kur u futa në atë shtëpi e pashë veten në mes të gjithë atyre mirësive dhe rashë në mendime, se sa shumë dashamirësi ka treguar Zoti ndaj këtij robi kaq të vogël dhe të parëndësishëm prandaj edhe mu zgjua dëshira për ta falënderuar dhe për t’ju falur Atij. E pashë të nevojshme se përpara çdo gjëje tjetër, të falënderoj dhe t’i falem Zotit tim. Që sonte do të shkoj pranë gruas sime.” I Dërguari i Zotit i tregoi Zijadit thelbin e çështjes. Xhujberi dhe Zelfa u martuan dhe ia kalonin përsëmbari së bashku. Filloi një luftë e shenjtë. Xhujberi, me atë zellin dhe entuziasmin që është veçori e burrave besimtarë mori pjesë në luftën e shenjtë nën flamurin e Islamit dhe ra dëshmor. Pas kësaj, asnjë gruaje tjetër nuk i kërkohej dora për martesë aq sa iu kërkonte Zelfës dhe për asnjë grua tjetër nuk ishin të gatshëm të shpenzonin para aq shumë sa ishin të gatshëm të shpenzonin për Zelfën.⁸

8 “Tregime për njerëzit e vërtetë”, f. 273, nga Usul Kafi.



“Paraja e bekuar”

(vijon nga faqja 43)

...Rrugës Profeti pa një skllave të vogël që po qante. Profeti i shkoi pranë dhe e pyeti:

- “Pse po qan?”

- “Të zotët e shtëpisë më dhanë mua katër derhem dhe më dërguan në pazar për të blerë; nuk e di se si ndodhi dhe i humba paratë, e tani nuk guxoj të shkoj në shtëpi.”

I Dërguari i Zotit hoqi katër derhem prej dymbëdhjetë derhemëve të veta, ia dha skllaves së vogël dhe i tha: “Bli ç’kishe për të blerë dhe kthehu në shtëpi”. Pastaj, vetë shkoi në pazar, ku bleu një këmishë prej katër derhemësh dhe e veshi. Kur po kthehej pa një njeri gati të zhveshur; hoqi këmishën nga trupi dhe ia dha atij. Shkoi sërish në pazar ku bleu një këmishë tjetër po me katër derhem, e veshi dhe mori rrugën për t’u kthyer në shtëpi. Kur po kthehej, nga mesi i rrugës i zunë sytë përsëri atë skllaven e vogël e cila ishte ulur dhe po rrinte si e shastisur dhe në një gjendje të trishtuar.

Profeti e pyeti:

- “Pse nuk ke shkuar në shtëpi?”

- “O i Dërguar i Zotit, u bë shumë vonë prandaj kam frikë se më godasin nëse kthehem në shtëpi.”

- “Eja të shkojmë së bashku. Ma trego shtëpinë tënde mua dhe unë do ndërhyj që ato mos të të godasin.”

Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) së bashku me skllaven e vogël morën rrugën për në shtëpi. Sapo arritën tek dera e shtëpisë, skllavja tha: “Ja, kjo është shtëpia.”

I Dërguari i Zotit thirri me zë të lartë:

- “O të zotët e shtëpisë! Paqja qoftë mbi ju (es selamu alejkum).” Nuk u dëgjua asnjë përgjigje. Thirri sërish duke e çuar por edhe herën e dytë nuk mori asnjë përgjigje. Kur thirri për të tretën herë, atëherë iu përgjigjën: -“Paqja e Zotit, mëshira dhe begatia e Tij qofshin mbi ty o i Dërguar i Zotit!” Kur dolën të zotët e shtëpisë për ta takuar Profeti i pyeti: - “Përse nuk mu përgjigjët që në fillim kur ju thirra, apo nuk më dëgjuat zërin?”

- “Sigurisht që e dëgjuam dhe e dalluam që ishit ju.”

- “Atëherë përse u vonuat?”

- “O i Dërguar i Zotit, po na vinte ëmbël tek dëgjonim në mënyrë të përsëritur selamin tuaj, sepse selami dhe përshëndetja juaj është bekim,

bereqet dhe shëndet për shtëpinë tonë.”

- “Kjo shërbëtorja juaj ishte bërë vonë, prandaj kam ardhur pranë jush që t’ju lutem, të mos i tërhiqni vërejtje asaj.”

- “O i Dërguar i Zotit për hir të ardhjes suaj të nderuar këtu, që tani po e lë të lirë këtë skllave.”

Profeti tha: “Falënderuar qoftë Zoti, ata dymbëdhjetë derhem sa me mirësi paskan qenë, veshën dy njerëz dhe liruan një skllave.”⁹



“Rrobat gjithë shkëlqim”

(vijon nga faqja 45)

...Ata u shqetësuan shumë dhe mbetën si të shastisur. Më në fund, këtë ngjarje ia parashtruan Aliut (paqja qoftë mbi të!). Ai tha: “Mendoj se rrobat tuaja gjithë shkëlqim janë bërë shkak që Profeti (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) të sillet kështu me ju”. Kështu, ata veshën rroba të thjeshta dhe hoqën unazat e shtrenjta; shkuan te Profeti dhe e përshëndetën. Këtë herë Profeti ia ktheu përshëndetjen dhe u foli atyre me përzemërsi.

⁹ “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 289, nga Bihar el Envar.

Pastaj, shokëve të tij u tha: “Betohem në Zotin, i Cili më ka dërguar mua në të vërtetë, herën e parë që këta erdhën pranë meje, vura re se edhe shejtani kishte ardhur me ta.” ¹⁰



“Iftari”

(vijon nga faqja 47)

... Enesi ishte në pritje që i Dërguari i Zotit t’i kërkonte ushqim atij dhe ky të kërkonte falje për atë çka kish bërë; mirëpo, Profeti i nderuar e kuptoi se çfarë kishte ngjarë nga ngjyrat e fytyrës që i shkonin e i vinin, prandaj edhe nuk e zu me gojë ushqimin dhe i uritur u shtri në shtrat. Enesi tha: “I Dërguari i Zotit sa ishte gjallë, kurrë nuk e ka përmendur dhe as që ma ka zënë me gojë ndodhinë e asaj nate.” ¹¹



10 “Tregime për njerëzit e vërtetë”, vëll. 1, f.111, nga Sefinetul Bihar.

11 “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 312, nga Kehl el Basr.

“Prova e zgjuarsisë”

(vijon nga faqja 51)

... Meqë më në fund, nga ana e të pranishëmve nuk arriti të jepej përgjigja e duhur, vetë Profeti tha: “Të gjitha këto që ju përmendët janë punë të mëdha dhe të nderuara (të virtytshme), mirëpo, asnjëra prej tyre, nuk është ajo që pyeta unë. Pika mbështetëse më e fortë e besimit është të duash për hir të Zotit dhe të urresh për hir të Zotit.”¹²



“Ruajtja e ekuilibrit, madje, edhe në adhurim” *(vijon nga faqja 53)*

...Ai tha: “O i Dërguar i Zotit më lejoni që të jap dy të tretat e pasurisë time në shenjë falënderimi ndaj kësaj mirësie.” Profeti (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) u përgjigj: “Jo!”

Ebu Lebadja tha: “Atëherë më lejo që të jap një të tretën e pasurisë sime.”

Profeti i nderuar (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) sërish iu përgjigj: “Kaq mundet. Islami këshillon që çdo gjë duhet të

¹² “Tregime për njerëzit e vërtetë” faqe 271, nga Kafi.

llogaritet, madje, edhe mbi çështjet e dhurimit dhe të sacrificës, na thotë: ‘Ruaje një pjesë dhe mos e tepro.’ Përse do që ta dhurosh për lëmoshë të tërë pasurinë që ke? Pastaj, gruaja dhe fëmijët e tu çdo të bëjnë? Vetëm një pjesë, një të tretën dhuroje në rrugë të Zotit, ndërsa atë çka mbetet ruaje.”¹³



“Gara e peshëngritjes”

(vijon nga faqja 58)

... Të gjithë ishin në pritje dhe të shqetësuar se cilin prej tyre do të shpallte kampion Profeti i nderuar (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!). Kishte disa, të cilët mendonin me vete, që ja tani i Dërguari i Zotit do t’i afrohet e do t’i kapë dorën atij dhe do ta shpallte atë kampion. Atëherë, i Dërguari i Zotit tha: “Më i fortë nga të gjithë, është ai person që kur tërhiqet nga diçka, lidhja me këtë gjë nuk bëhet shkak që ta nxjerrë atë person nga boshti i së vërtetës dhe i respektit dhe ta njollosë atë me vepra të këqija, e nëse do të nevríkosej për diçka dhe vala e zemërimit do të ngrihej nga shpirti i tij,

¹³ “Jetëshkrimi dhe fjala e Profetit të nderuar”, faqe 174, nga *Ligjërata Shpirtërore*.

e ruan kontrollin e vetvetes, nuk thotë asgjë tjetër përveç të vërtetës dhe nuk nxjerr nga goja asnjë fjalë të rreme dhe fyese. Dhe, nëse do të fusë në dorë fuqi dhe ndikim dhe mandej do t'i hiqen pengesat dhe bllokadat që i rrinë përpara, nuk e tepron duke e zgjatur dorën më shumë se ç'meriton.”¹⁴



“Burri që kërkonte ndihmë”

(vijon nga faqja 60)

...Kësaj here, sapo e dëgjo i sërish këtë fjali, ndjeu një siguri më të madhe në zemrën e vet. Ndjeu se e gjeti çelësin e zgjedhjes së hallit të vet brenda kësaj fjalie. Kur doli jashtë filloi të hidhte hapa më të sigurt. Tashmë po mendonte me vete: “... kurrë nuk do të rend më në kërkim të ndihmës së njerëzve; do t'i mbështetem Zotit dhe do të shfrytëzoj prej fuqisë dhe talentit që gjendet në qenien time dhe do t'i kërkoj Atij që të më japë sukses në zanatin të cilin do të zgjedh për të bërë e të më bëjë mua të mos kem nevojë për asgjë.” Mendonte me vete se ç’punë

¹⁴ “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 96, nga Vesialesh Shia.

mund të bënte? I erdhi në mendje se tani për tani vetëm kaq mund të bënte, të shkonte në shkretëtirë dhe të mblidhte shkarpa për zjarr e të vinte t'i shiste ato. Shkoi mori hua një sqepar dhe u nis drejt shkretërirës ku mblodhi shkurret e shkarpat e më pas i shiti. Këtu ia shijoi frytin e arritur me mundin e vet. Edhe ditëve të tjera ai i dha vijimësi kësaj pune, derisa arriti që prej parave të fituara të blinte sqeparin, kafshët dhe sendet e tjera të nevojshme të tijat. E vazhdoi përsëri këtë punë derisa vuri pasuri dhe mori edhe shërbëtorë. Një ditë i Dërguari i Zotit iu afrua atij duke buzëqeshur dhe i tha: “A nuk të thashë se ne do t'i ndihmojmë këdo që na kërkon ndihmë, mirëpo, nëse dikush është në nevojë dhe mundohet që ta shmangë atë, Zoti i Madh do ta bëjë atë që të mos jetë më në nevojë.”¹⁵



15 “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 4, nga Usul Kafi.

“Djali i Hatemit”

(vijon nga faqja 64)

... (në kohën që Adi tha: “Unë jam djali i Hatem Tajit”) Profeti e respektonte atë dhe e mori me vete në shtëpi. Nga mesi i rrugës kur Profeti dhe Adi po ecnin një grua e moshuar i doli përpara Profetit dhe filloi ta pyes. Kaloi një farë kohe dhe Profeti filloi t’i përgjigjej me dashamirësi dhe durim gruas. Adi tha me vete: “Kjo është një shenjë e moralit të këtij burri, që tregon se është Profet. Pushtetarët dhe ata që rendin pas kësaj dynjaje nuk kanë një edukatë të këtillë sa që t’i përgjigjen një gruaje plakë dhe fatkeqe me kaq dashamirësi dhe durim.” Sapo që Adi hyri brenda në shtëpinë e Profetit, vuri re se pajisjet e jetesës së Profetit ishin mjaft të thjeshta dhe jo luksoze. Atje ishte vetëm një dyshek, ku dukej qartë se në të ulej vetë Profeti. Profeti ia shtroi dyshekun Adit. Sado që Adi këmbënguli që në të të ulej vetë Profeti, përsëri Profeti nuk pranoi. Adi u ul mbi dyshek ndërsa Profeti u ul në tokë. Adi tha me vete: “Kjo është shenja e dytë e moralit të këtij burri, që përkon me moralet e Profetëve dhe jo të mbretërve.” Profeti u drejtua nga Adi e i tha: - “Vallë, a nuk i përkisje ti besimit Rekusi?”¹⁶ - “Po” - u përgjigj Adi.

16 Medh’hebi apo drejtimi Rekusi ka qenë prej degëve të Kristianizmit (Jetëshkrimi Ibni Hishamit).

- “Atëherë, pse dhe me çfarë autoriteti dhe justifikimi mblihdje ti një të katërtën e të ardhurave të popullit tënd? Në fenë tënde kjo punë nuk lejohet.”

Adi, i cili deri tani e kishte mbajtur të fshehtë fenë e vet, madje edhe prej njerëzve më të afërt të tij, mbeti mjaft i habitur nga fjalët e Profetit dhe tha me vete: “Kjo është shenja e tretë që tregon se ky burrë është Profet”. Pastaj, Profeti i tha Adit: “Ti po shikon varfërinë dhe dobësinë e aftësive ekonomike të sotme të myslimanëve dhe po shikon që myslimanët në kundërshtim me popujt e tjerë janë të varfër. Tjetër gjë që ti shikon sot, janë turmat e armiqve që kanë rrethuar myslimanët dhe ata nuk janë të sigurt as për jetën dhe as për mallin e tyre. Tjetër gjë që ti shikon është kjo që pushteti dhe fuqia janë në duart e të tjerëve. Të betohem në Zot, që kjo gjendje nuk do të zgjasë shumë dhe myslimanëve do t’ju bjerë në duar kaq shumë pasuri sa në mes tyre nuk do të mund të gjendet një i varfër. Betohem në Zot, se aq shumë do të shtypen dhe dërrmohen armiqtë e tyre dhe do të vendoset një siguri e plotë, sa që një femër do të mund të udhëtojë e vetme prej Irakut deri në Hixhaz dhe askush nuk do të guxojë ta bezdisë atë. Betohem në Zot, se është afër koha kur kullat e bardha të Babilonisë do të bien në duart e myslimanëve.”

Adi me besim të plotë dhe me nijet të singertë

pranoi Islamin dhe deri në fund të gjithë jetës i qëndroi besnik Islamit. Ai jetoj edhe shumë vite të tjera pas Profetit të nderuar. Ai përherë i ruante në mendje të gjalla fjalët që Profeti i kishte thënë kur ky ishte ndeshur për herë të parë me të dhe parashikimet që Profeti kishte bërë për të ardhmen e myslimanëve dhe thoshte: “Betohem në Zot se nuk vdiqa dhe arrita të shikoj se si kullat e bardha të Babilonisë u çliruan nga duart e myslimanëve. U vendos rendi dhe siguria, sa që një grua mund të udhëtonte e vetme nga Iraku në Hixhaz, pa mundur që atë ta bezdisë ndokush. Betohem në Zot se kam besim që do të vijë një kohë kur në mesin e myslimanëve nuk do të gjendet as edhe një i varfër.”¹⁷



“Gara e vrapimit me deve”

(vijon nga faqja 70)

...Një tension i çuditshëm vihej re në mes të spektatorëve, mirëpo, përkundër asaj që prisnin njerëzit, deveja e beduinit e la pas deven e Profetit. Ata myslimanë, të cilët kishin krijuar

¹⁷ “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 262, nga Jetëshkrimi i Ibni Hishamit.

një besim të veçantë për devenë e Profetit u shqetësuan pa masë nga kjo që ngjau. Kjo gjë ishte mjaft kundër asaj ç'ka prisnin prandaj, u vrenjtën në fytyra. I Dërguari i Zotit u tha atyre: “Kjo gjë s’është për tu shqetësuar. Deveja ia kalonte të gjithave, por i hyri vetja në qejf, u bë mendjemadhe dhe thonte me vete ‘unë s’kam të parë’”. Mirëpo, ligji i Zotit është që mbi çdo pëllëmbë të gjendet një pëllëmbë tjetër dhe pas çdo ngritjeje t’ia arrijë ulja dhe çdo mendjemadhësi të shpërbëhet. Sipas këtij rendi të të Dërguarit të Zotit, përmbjatja e sqarimit të kësaj mençurie ia mbushi mendjen atyre për gabimet e veta.¹⁸



“Te dijetari”

(vijon nga faqja 73)

...I Dërguari i Zotit urdhëroi e tha: “Nëse gjenden persona të tjerë që ta përcjellin dhe varrosin xhenazen, atëherë shko tek kuvendi i dijes. Padyshim, se pjesëmarrja në një kuvend dijeje është më e mirë se sa prania në një mijë përcjellje xhenazesh, më e mirë se sa një mijë

¹⁸ “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 342, nga Vesail esh Shia.

vizita të sëmurësh, më e mirë se sa një mijë net adhurimi, më e mirë se sa një mijë ditë agjërim, më e mirë se sa një mijë haxhe të detyrueshme, më e mirë se sa një mijë luftra të shenjta (xhihade) jo të detyrueshme. E, si mund të krahasohen këto me të qënit në prani të dijetarit?! A nuk e di vallë, se me anë të dijes bëhet i mundur adhurimi që i bëhet Zotit. Mirësia kopsitet me dijen, ashtu siç është i kopsitur sherri i kësaj bote dhe i Botës Tjetër me injorancën.”¹⁹



“Në shtëpinë e Ummu Selemes”

(vijon nga faqja 75)

... Ummu Selemja shkoi dhe u ul në një qoshe dhe zuri të qajë. Ummu Selemja po qante aq me ngashërim saqë Profeti erdhi dhe e pyeti atë: -“Përse po qan?” -“Përse të mos qaj kur ti duke pasur gjithë këtë pozitë të lartë tek Zoti je kaq i frikësuar nga Zoti dhe i lutesh Atij që mos të të braktisë qoftë edhe për një çast të vetëm, atëherë vaj halli për ata si unë.” - “O Ummu Seleme, e si mundem unë të mos jem

¹⁹ “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 476, nga Biharul En-var.

i shqetësuar dhe ta kem mendjen e mbledhur kur profeti Junus, vetëm për një çast ndodhi vetëm dhe e gjeti ajo çka e gjeti?!”²⁰



“Fjala që i dha fuqi Ebu Talibit”

(vijon nga faqja 77)

... Ky ultimatum i thënë copë, e shqetësoi mjaft Ebu Talibin. Asnjëherë tjetër deri në atë ditë nuk kishte dëgjuar të tilla fjalë të vrazhda prej kurejshëve. Ishte e qartë se Ebu Talibi nuk e kishte mundësinë të rezistonte dhe të përballej me kurejshët dhe nëse vendoste ta çonte punën në stepa të rrezikshme, atëherë do të rrënohej vetë bashkë me djalin e vëllait të tij, familjarët dhe të afërmit e vet. Ky ishte shkaku që ai dërgoi dikë tek i Dërguari i Zotit dhe me anë të tij ia parashtroi problemin dhe i tha: “Tani që puna ka arritur deri këtu, hesht, sepse si unë ashtu edhe ti, që të dy jemi në rrezik.” Profeti i nderuar e ndjeu se ultimatum i kurejshëve kishte ndikuar tek Ebu Talibi, prandaj si përgjigje i tha një fjali Ebu Talibit që i fshiu të gjitha fjalët e kurejshëve nga mendja

²⁰ “Jetëshkrimi dhe fjalët e Profetit të nderuar”, faqe 87, nga Biharul Envar.

e tij: “O xhaxha i dashur! Po të them vetëm kaq që nëse do t’i vinin diellin në dorën time të djathtë dhe hënën në dorën time të majtë që të hiqja dorë nga feja ime, kurrë nuk do të heq, derisa Zoti ta shfaqë haptazi fenë e Vet, ose që unë të jap jetën në krye të kësaj pune.” Tha këtë fjali, zunë t’i rridhnin lotët dhe u largua nga Ebu Talibi. Nuk kishte bërë ende disa hapa, kur u urdhërua prej Ebu Talibit të kthehej mbrapsht. Ebu Talibi i tha atij: “Tani meqë është kështu, atëherë vepro ashtu siç di vetë. Betohem në Zot, se do të të mbroj deri në frymën e fundit!”²¹



“Logjika e Profetit”

(vijon nga faqja 80)

... në vend që Profeti të gëzohej nga shpjegim i njerëzve dhe si shumë politikanë të shfrytëzojë rastin për të propaganduar dhe për të përdorur këto lloj ndjenjash të popullit në të mirë të Islamit, jo vetëm që nuk veproji kështu, por nuk ia lejoi vetes as heshtjen. Erdhi në xhami dhe u ngjit lart në minder dhe i lajmëroi njerëzit se

²¹ “Jetëshkrimi dhe fjala e Profetit të nderuar”, faqe 95, nga sireje Ibn Hisham.

dielli ka qenë i zënë, por kurrsesi nuk ishte i zënë për hir të fëmijës tim. Profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), kurrë nuk ka dashur që të përfitojë prej pikave të dobëta dhe injorancës së shoqërisë për udhëzimin e popullit dhe përparimin e Islamit, mirëpo përpiquej që të përdoreshin pikat e forta, dija, njohuria dhe zgjimi i njerëzve, sepse Kur'ani e kishte urdhëruar atë: “O Profet! Ftoji njerëzit në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë dhe diskuto me ta me mënyrën më të mirë”

Qëllimi është i rëndësishëm ndërsa, mjeti le të jetë çfarë të dojë. Profeti me veprimin e vet e kundërshtoi këtë logjikë të ulët; madje nuk donte të abuzonte qoftë edhe me heshtjen e vet, sepse së pari, Islamit nuk i nevojiten gjëra të këtilla; personat që duhet të përfitojnë prej këtyre lloj çështjeve janë ata ku feja dhe institucioni i tyre nuk ka arsyetim, logjikë dhe argument e ku gjurmët dhe vështirësia e fesë së tyre nuk janë të qarta dhe të dukshme; së dyti, Zoti i Madhëruar nuk u jep një leje të këtillë Profetëve dhe myslimanëve, sepse për të vërtetën duhet përdorur vetëm e vërteta, ndërsa në të kundërt përzierja e të vërtetës me të shtrembërtën (Hakut dhe Batilit) e asgjësojnë të vërtetën.²²

22 “*Jetëshkrimi dhe fjala e Profetit të nderuar*”, faqe 133, nga Siretu Nebvij.



“Mësuesi më i mëshirshëm”

(vijon nga faqja 83)

“...Në kohën që namazi mbaroi, i Dërguari i Zotit më thirri që t’i shkoja pranë. Për Zotin që nuk kam parë ndonjë mësues tjetër më të mirë se ai, si para tij ashtu edhe pas tij. As më gjuajti dhe as më thirri mbi krye, por qetësisht më tha: ‘Ky namaz nuk është i saktë sepse u fjalose kur po faleshe. Namazi është vetë tespîh, tekbir, dhe këndim Kur’ani.’”²³



“Profeti i mëshirës”

(vijon nga faqja 85)

...Në kohën që Hatibi erdhi tek Profeti, ai i tha atij:

- “Përse ia ke shkruar këtë letër idhujtarëve?”

Hatibi i tha: “O i Dërguar i Zotit! Muhaxhirët të cilët kanë emigruar nga Mekka në Medine

²³ “Jetëshkrimi i të Dërguarit të Zotit”, faqe 261.

kanë njerëz të vetët ne Mekke nga të cilët ruhen dhe mbështeten, ndërsa unë nuk kam ruajtës dhe mbështetës të këtillë, prandaj me anë të kësaj letre synova që të tërheq ruajtjen dhe mbështetjen e tyre për veten time. Veprimi nuk ka ardhur si pasojë e mosbesimit (kufrit) apo heqjes dorë nga besimi.” Profeti ia pranoi shpjegimin dhe i tha: - “Fole drejt.” Umer ibn Hatabi, i cili ishte i pranishëm, tha: - “O i Dërguar i Zotit më jep jele që ta çoj drejt vdekjes (ta vras) këtë hipokrit (munafik).” Profeti urdhëroi dhe i tha: “Ky burrë ka marrë pjesë në luftën e Bedrit, prandaj ka mundësi që Zoti ta falë.”²⁴



“Fatkeqësia (belaja) e pasurisë”

(vijon nga faqja 88)

...Nuk kaloi shumë dhe qëlloi që vdiq djali i xhaxhait pasanik të Thalabes dhe atij i ra në duar një pasuri e madhe. Disa thanë se bleu dele të cilat u shtuan shumë shpejt saqë nuk qe më e mundur mbikëqyrja e tyre në qytetin e Medines. I detyruar iu drejtua vendbanimeve rreth Medines dhe u dha aq shumë pas të mirave materiale saqë jo vetëm nuk merrte

24 “Profetësia dhe Profeti i Islamit”, faqe 199.

pjesë në namazin me xhemat (falje në bashkësi) por as edhe në namazin e xhumasë (faljen e së Premtes). Pas një farë kohe, Profeti dërgoi tek ai të ngarkuarin me detyrë për mbledhjen e zekatit, pra t'i merrte atij zekatin e mallit të vet, mirëpo, ky njeri dorështrenguar që sapo kishte parë para me sy, ngurroi që të paguante të drejtën e Zotit; jo vetëm që nuk e dha zekatin, por edhe kundërshtoi edhe thelbin e ligjvënies së këtij urdhri dhe tha: “Ky urdhër është vëllai i xhizjes.” [(d.m.th. i njëjtë me xhizjen) që është taksa që i merr shteti islam atyre që nuk janë myslimanë por që janë ithtarë të Librit dhe që jetojnë në tokat e myslimanëve (shënim i përkthyesit)]. Nëse krahasojmë pagesën e xhizjes (taksë) me pagesën e zekatit përcaktohet se çfarë ndryshimi ka në mes nesh dhe atyre që nuk janë myslimanë, ndërkohë që ai nuk e kishte kuptuar as domethënien e xhizjes dhe as kuptimin e zekatit, mirëpo pëlqimi i kësaj bote nuk e lejonte atë që t'i shfaqej e vërteta dhe e drejta. Në kohën që fjalët e tij arritën në vesh të të Dërguarit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të) ai tha: “Vaj për Thabelen, vaj për Thabelen”.²⁵

25 “Tregime kur'anore”, faqe 692.



“Mbledhja e shkarpaveve në shkretëtirë”
(vijon nga faqja 90)

...Profeti i nderuar tha: “Edhe gjynahet e vogla janë si këto shkarpat e rralla, që fillimisht nuk bien në sy, mirëpo, çdo gjë ka kërkuar dhe ndjekës, ashtu sikur që edhe ju kërkuat dhe ndoqët dhe mblodhët këtë grumbull shkarpash, ashtu mbillen dhe marrin përmasa të mëdha edhe gjynahet tuaja dhe një ditë do të shikoni se si nga ato gjynahet e vogla që nuk binin në sy është mbledhur grumbull gjigand.”²⁶

26 “Tregime për njerëzit e vërtetë”, faqe 204, nga Vesail esh Shia.

Përmbajtja e lëndës

Rruga e vështirë e Profetëve,	
“Misioni i Profetit”.....	5
◦Burri që kërkoi këshillë.....	20
◦Beduini dhe Profeti Muhammed.....	22
◦Mëshira dhe dashuria.....	24
◦Falja në kohën e fuqisë.....	26
◦Ushqimi i përbashkët.....	28
◦Fqinji i ri.....	30
◦I mjeri dhe pasaniku.....	33
◦Xhujberi dhe Zelfa.....	35
◦Paraja e bekuar.....	43
◦Rrobat gjithë shkëlqim.....	45
◦Iftari.....	47
◦Prova e zgjuarsisë.....	51
◦Ruajtja e ekuilibrit, madje, edhe në adhurim.....	53
◦Gara e peshëngritjes.....	58
◦Burri që kërkonte ndihmë.....	60
◦Djali i Hatemit.....	64
◦Gara e vrapimit me deve.....	70
◦Te dijetari.....	73
◦Në shtëpinë e Ummu Selemes.....	75
◦Fjala që i dha fuqi Ebu Talibit.....	77
◦Logjika e Profetit.....	80
◦Mësuesi më i mëshirshëm.....	83
◦Profeti i mëshirës.....	85
◦Fatkeqësia (belaja) e pasurisë.....	88
◦Mbledhja e shkarpaceve në shkretëtirë.....	90

Vazhdimi i tregimeve.....92

◦Burri që kërkoi këshillë (<i>vijon nga faqja 20</i>).....	92
◦Beduini dhe Profeti Muhammed (<i>vijon nga faqja 22</i>).....	93
◦Mëshira dhe dashuria (<i>vijon nga faqja 24</i>).....	95
◦Falja në kohën e fuqisë (<i>vijon nga faqja 26</i>).....	95
◦Ushqimi i përbashkët (<i>vijon nga faqja 28</i>).....	96
◦Fqinji i ri (<i>vijon nga faqja 30</i>).....	97
◦I mjeri dhe pasaniku (<i>vijon nga faqja 33</i>).....	97
◦Xhujberi dhe Zelfa (<i>vijon nga faqja 35</i>).....	99
◦Paraja e bekuar (<i>vijon nga faqja 43</i>).....	102
◦Rrobat gjithë shkëlqim (<i>vijon nga faqja 45</i>).....	104
◦Iftari (<i>vijon nga faqja 47</i>).....	105
◦Prova e zgjuarsisë (<i>vijon nga faqja 51</i>).....	106
◦Ruajtja e ekuilibrit, madje, edhe në adhurim (<i>vijon nga faqja 53</i>).....	106
◦Gara e peshëngritjes (<i>vijon nga faqja 58</i>).....	107
◦Burri që kërkonte ndihmë (<i>vijon nga faqja 60</i>).....	108
◦Djali i Hatemit (<i>vijon nga faqja 64</i>).....	110
◦Gara e vrapimit me deve (<i>vijon nga faqja 70</i>).....	112
◦Te dijetari (<i>vijon nga faqja 73</i>).....	113
◦Në shtëpinë e Ummu Selemes (<i>vijon nga faqja 75</i>).....	114
◦Fjala që i dha fuqi Ebu Talibit (<i>vijon nga faqja 77</i>).....	115
◦Logjika e Profetit (<i>vijon nga faqja 80</i>).....	116
◦Mësuesi më i mëshirshëm (<i>vijon nga faqja 83</i>).....	118
◦Profeti i mëshirës (<i>vijon nga faqja 85</i>).....	118
◦Fatkeqësia (belaja) e pasurisë (<i>vijon nga faqja 88</i>).....	119
◦Mbledhja e shkarpave në shkretëtirë (<i>vijon nga faqja 90</i>).....	121

